

# Plani Rregullativ Urban (PRRU) QENDRA E JUNIKUT

RAPORT, Qershor 2009

Republika e Kosovës  
Republika Kryesore  
Republic of Kosovo  
**KOMUNA JUNIK**  
**OPĆINA JUNIK**  
MUNICIPALITY JUNIK

**MetroPolis**  
Associated American Cities

www.municipalities.org

**RAPORT**  
**Qershor 2009**

**Plani Rregullativ Urban (PRRU)**  
**QENDRA E JUNIKUT**



Projeti i përfunduar



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republika di Kosovë  
KOMUNA JUNIK  
UPSTINA JUNIK

Kontraktues menaxheri

Fatih Kafalaj  
Kryetari i Komunes se Junikut

Kontraktues profesionali

Ene Tashku arkitekt  
Përgjegjës menaxher



E ed Fequ. arkitekt  
Përgjegjës profesional

Shemburi: Kjo dokument konsiderohet zyrtare përdorur për qëllim të vlerave të institucioneve

## - Përbajtja -

Ekipi projektues.....	4
Akronimet dhe shpjegimet terminologjike.....	6
Vizioni.....	7
<b>I. PREZANTIM</b>	
1.1 Dokumentacioni bazë.....	8
1.2 Motivimi.....	8
1.3 Baza legjislative.....	9
1.4 Zona e planit rregullues urban / harta kadastrale.....	9
1.5 Qëllimet strategjike.....	10
<b>II. PROFILI I GJENDJES URBANE</b>	
2.1 Zhvillimi historik i qendrës urbane.....	11
2.2 Lidhja e qendrës me rajonin.....	13
2.3 Lidhja e qendrës me territorin urban.....	14
<b>III. ATRIBUTET FIZIKO-GJEOGRAFIKE</b>	
3.1 Klima.....	16
3.2 Hidrologjia .....	16
3.3 Topografija.....	18
<b>IV. ATRIBUTET KULTURORE</b>	
4.1 Analiza e pronësisë.....	19
4.2 Analiza e rrjetit rrugorë.....	21
4.3 Analiza bosh-plot.....	23
4.4 Analiza e altimetrisë.....	25
4.5 Morfollogji urbane dhe tipologjitet e ndërtimit.....	26
4.6 Përdorimi i truallit dhe i objekteve.....	28
4.7 Analiza e trashëgimisë Kulturore dhe Historike.....	32
<b>V. PEJSAZHI</b>	
5.1 Lidhja ndërmjet ambientit urban dhe natyrës.....	35
5.2 Analizë e trajktoreve përshkuese urbane dhe poleve.....	37
<b>VI. KONCEPTI.....</b>	39
<b>VII. OBJEKTIVAT.....</b>	40
<b>VIII. RREGULLORJA</b>	42
8.1 Hyrje.....	42
8.2 Organizimi i territorit urban sipas PRRU-së.....	42
8.3 Kufiri i zonës së PRRU-së.....	42
8.4 Destinimi i sipërfaqeve sipas PRRU-së.....	43
8.5 Specifikimi dhe rregulat mbi përdorimin e truallit.....	44
<b>IX. REGULLAT E KUALIFIKIMIT HAPËSINOR</b>	
9.1 Rregullorja e përgjithshme.....	50
<b>X. TIPOLOGJITË NDËRTIMORE</b>	
10.1 Përshkrim i përgjithshëm.....	50
10.2 Tipologji ndërtimore bazë.....	51
10.3 Tipologji ndërtimore speciale .....	55
<b>XI. RREGULLIMI I PARCELAVE NDERTIMORE</b>	
11.1 ISHP-Indeksi i shfrytëzimit të parcelës .....	56
11.2 N.Kt-Numri i kateve.....	56
11.3 Vija rregulluese .....	56
11.4 Vija ndërtimore .....	57
11.5 Distançat minimale ndërmjet objekteve.....	57

11.6 Kushtet e parcelimit dhe riparcelimit.....	58
11.7 Kushtet për nderprerjen e vargut ndërtimorë.....	58
11.8 Kushtet e hyrjes në parcelë dhe parkimi.....	58
11.9 Kushtet për definimin e rrrethojave.....	59
11.10 Kushtet për renoviminin dhe rindërtimin e objekteve ekzistuese.....	59
11.11 Kushtet për hapësirat e lira.....	59
ANEKS 1 – Intenerari Turistik .....	60
ANEKS 2 – Tregu (“Çarshia e re”) i Junikut .....	64
ANEKS 2 – Parku I Erenikut .....	67
Bibliografia e Referencës .....	73

## EKIPI PROJEKTUES (Plani Rregullativ Urban QENDRA E JUNIKUT)

<b>Pronar i projektit</b>	 <p style="text-align: center; margin-top: -10px;">         Republika e Kosovës          Dërgatët e Komunës          Rregullativ Urban  <b>KOMUNA JUNIK</b>  <b>DISTINA JUNIK</b>  <b>MUNICIPALITY JUNIK</b> </p> 
<b>Përkatës profesional të projektit nga Komuna e Junikut</b>	Komuna e Junikut Tahir ISUFAJ/ Kryetar i Komunës Shkodran GAXHERRI / Nënkyetari i Komunës Xhavit VELIAJ / Drejtor i Drejtoratit për Planifikim, Urbanizëm, Gjeodezi dhe Kadastër Xhemë SHEHU / Zyrtar për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë Ferdone TOFAJ / Zyrtare për Planifikim
<b>Kontraktues menagjerial</b>	 <p style="text-align: center; margin-top: -10px;">         Trashëgimia Kulturore pa Kufij, Suedi / zyra në Kosovë       </p>
<b>Drejtues menagjerial i projektit</b>	Enes TOSKA, arkitekt
<b>Konsulent profesional i projektit</b>	Agron SALLOVA, arkitekt
<b>Kontraktues profesional</b>	 <p style="text-align: center; margin-top: -10px;">         Metro_Polis sh.p.k – Tiranë, Shqipëri       </p>
<b>Drejtues profesional i projektit</b>	Eled FAGU, arkitekt
<b>Konsulentët profesional të projektit</b>	 <p style="text-align: center; margin-top: -10px;">         Universiteti Polis - Tiranë, Shqipëri       </p>
	Dr. Besnik ALIAJ, planifikues urban
	MPA Sotir DHAMO, planifikues urban
<b>Ekipi projektues</b>	Edon MULLAFETAHU, kand. arkitekt / koordinator i ekipit
	Arta XHAMBAZI, arkitekte
	Blerim KURTISHI, kand. arkitekt
	Eltion BOÇI, kand. urbanist
	Klesti REÇA, kand. arkitekt
	Meriton BERISHA, kand. arkitekt
	Mimoza SYLEJMANI, arkitekte
	Mirian BLLACI, kand. urbanist
	Senat HALITI, kand. arkitekt

	Sonila SHUTINA, kand. arkitekt
	Idriz SHALA, GIS eksperti
	Besnik MORINA, ekonomist
<b>Lekturimi</b>	Vlorë Berisha, linguiste
<b>Kontribuesit profesional institucional</b>	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
	Instituti për Planifikim Hapësinor
	Instituti për Mbrotjen e Monumenteve në Pejë
	Korporata Elektroenergjetike e Kosovës (KEK) / Distrikti Pejë
	Komisioni i pavarur për Miniera dhe Minerale
	Kompania Regionale e Ujësjellësit “Hidrodrini” – Njësia Junik
	UN-Habitat

## AKRONIMET DHE SHPJEGIMET TERMINOLOGJIKE

**CHwB-** Cultural Heritage without Borders  
(Trashëgimia kulturore pa kufij)

**UN-Habitat-** The United Nations agency for human settlements (Agjencioni i Kombeve të Bashkuara për vendbanimet njerëzore)

**OSCE-** Organization of Security and Cooperation in Europe ( OSBE- Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Europë)

**PZHU-** Plani Zhvillimor Urban.

"Plani Zhvillimor Urban është plan strategjik multi-sektoral i cili përcakton synimet afatgjate për zhvillim dhe menaxhim të zonave urbane i cili duhet të përcaktojë zhvillim të ekuilibruar dhe të qëndrueshëm të zhvillimit hapësinor të zonave urbane dhe duhet të bazohet në qeverisjen e mirë dhe zhvillimin e përgjithshëm ekonomik, social, ekologjik dhe kulturor." Ligji për Planifikimin Hapësinor (Nr.2003/14), Neni 14

**ISHP-** Indeksi i Shfrytëzimit të Parcelës - paraqet raportin e sipërfaqes së lejuar për ndërtim të shputës së objektit kunddrejt sipërfaqes së parcelës që përfshihet brenda vijes rregulluese.

**N.Kt-** Numri i kateve - përcakton numrin e kateve të banueshme, të ndërtuara mbi dhe nën tokë

**B+P+1+Nk** = Bodrum + Përdhesë +1 kat + Nënkulm

**VN-Vija ndërtimore** - tregon vijën e ndarjes së parcelës për interes të përbashkët dhe për interes të veçantë brenda njësisë gjithashtu siguron korridorin për vendosjen e rrjetit të infrastrukturës, në koridorin ndërmjet saj dhe vijës së rrugës, si ujësjellësit, rrjetit elektrik, kanalizimit, telefonisë, etj.

**VR- Vija rregullative** - përcaktohet me distancë metrike në raport me vijën rregulluese. Çdo ndërtim i ri apo rindërtim duhet të pozicionohet me fasadë në vijën ndërtimore duke u shtrirë përbrenda hapësirës së kufizuar prej saj.

### Njësítë

**m** - metër

**mm** - milimetër

**km** - kilometër

**m<sup>2</sup>** - metër në katror

**SIDA-** The Swedish International Development Cooperation Agency (Agjencioni Ndërkombëtar Suedez për Zhvillim dhe Kooperim)

**KEK-** Korporata Elektroenergetike e Kosovës

**AKP-** Agjencia Kosovare e Privatizimit

**IPH-** Instituti i Planifikimit Hapësinor

**PRRU-** Plani Rregullues Urban.

"Me plane rregulluese urbane caktohen kushtet për rregullimin e hapësirës si dhe rregullat e lokacionit të objekteve dhe ngastrat tokësore urbane. Planet rregulluese urbane do të definojnë zonat e ndërtimit dhe do të përfshijnë linjat e rregullimit, linjat e ndërtimit, normat teknike urbanistike dhe kushtet tjera lidhur me lokacionin e ndërtesave dhe ndërtimet tjera në ngastrat tokësore urbane", Ligji për Planifikimin Hapësinor (Nr.2003/14), Neni 15

**Koridore urbane** - trajktore rrugore urbane

**Perde urbane** – fasadat e objekteve që perimetrojnë koridorin urban

**Objekte "perde urbane"** – paraqet tipologjinë ndërtimore ku objektet vendosen me fasada në vijën rregulluese duke krijuar vazhdimësi lineare të pandërprerë.

**Vargu ndërtimore** - nënkuption perde ndërtimore të vazhdueshme me distancë minimale të ndërtimeve nga njëri-tjetri.

**"cul de sac"-** (frëngjisht, fundi i thesit apo çantës) në planifikim urban do të thotë "rrugë corre" pra rrugë që ka vetëm një hyrje dalje.

**"bajpas"(bypass)-** në planifikim urban përdoret si sinonim për rrugët tranzitore që shërbojnë përmenjanimin e trafikut nga zonat në ndërtim, qytetet apo fshatrat dhe kanë për qëllim rregullimin e rrjedhshmërisë së trafikut dhe rritjen e sigurinës në trafik.

**nuklet katalitike**- janë elemente urbane që nxisin zhvillim varësisht nga funksioni urban që i përcaktohet.

**%** - përqind

**°** - shkallë

**°C** - gradë Celsius



## VIZIONI

*“Juniku, vend-themel i traditës dhe odës si institucion, “Park Etnografik” i trashëgimisë natyrore dhe kulturore, ruajtja e së cilës do të gjenerojë zhvillim të qëndrueshëm dhe mirëqenie për banorët e vet, me vend të merituar në ofertën turistike rajonale dhe integrime evropiane.”*

*(Ekstrakt i nxjerrë nga procesi i vizionimit mbajtur në Ohër në Tetor 2007)*

## I. PREZANTIM

### 1.1 Dokumentacioni bazë

Materialet në trajtë dokumenti zyrtarë, të shfrytëzuara për hartimin e këtij projekti janë:

1. Harta Kadastrale e vitit 1983
2. Harta Topografike 1: 25000
3. Planet Gjeodezike të vitit 1932
4. Foto ajrore të vitit 2004
5. Projekti i kanalizimeve (në zbatim)
6. Plani i Mbrojtjes dhe Zhvillimit të Junikut (2007)
7. Dokumenti i integruar i Vizionimit, Junik (2008)
8. (Draft) PZHU-Komuna Junik (Metro-POLIS 2008)

### 1.2 Motivimi

Komuna e Junikut është “Njësi” e re administrative e themeluar si rezultat i procesit të decentralizimit që udhëhiqet nga Qeveria e Kosovës. Deri në themelimin si komunë, Juniku konsiderohej si fshati më i madh në Kosovë.

Administrata e re e posa themeluar ka filluar konsolidimin e saj, duke themeluar Drejtoritë përkatëse të cilat duhet të menaxhojnë dhe drejtojnë politikat komunale. Ky proces është nën mbikqyrjen e autoriteteve qendrore (Qeveria e Kosovës) si dhe vëzhgohet nga OSBE-ja. Një ndër fushat më problematike, jo vetëm për Junikun por edhe për Komunat tjera të shtetit të ri, është Planifikimi Urban dhe Menaxhimi i Territorit.

Në bazë të Ligjit për Planifikim Hapësinor secila komunë është e obliguar që të hartojë instrumentet e Planifikimit, të cilat duhet të përfaqësojnë interesat e komunitetit dhe grupeve te ndryshme brenda tij. Në anën tjetër Juniku përfaqëson një trevë tipike me trashëgimi të pasur natyrore dhe kulturore. Ky fakt e bënë edhe me sfidues procesin e planifikimit urban.

CHwB ( Cultural Heritage without Borders) që vepron në Kosovë prej vitit 2001, me një eksperiencë të gjerë në fushën e konservimit dhe ruajtjes së trashëgimisë kulturore në vendet në tranzicion, në marrëveshje me UN-HABITAT (Zyra në Kosovë ) dhe Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor duke gjetur mbështetje të plotë nga Komuna e Junikut, ndërmarrin nismën për hartimin e instrumenteve urbanistik, PZHU- Plan Zhvillimor Urban dhe PRRU- Plan Rregullues Urban për qendrën e Junikut.

### **1.3 Baza legjislative**

Plani Rregullues Urban për qendrën e Junikut është mbeshtetur mbi këtë bazë ligjore:

- Ligjin për Planifikimin Hapësinor, Nr. 2003/14;
- Udhëzimin Administrativ mbi përbajtjen e Planit Rregullues Urban, Nr.02/05;
- Ligjin për Ndërtim, Nr.2004/15;
- Ligjin për Trashëgiminë Kulturore, 02/L-88;
- Ligjin për Rrugët, Nr.2003/11.

### **1.4 Zona e planit rregullues urban / harta kadastrale**

Plani Rregullues për qendrën e Junikut përfshin një sipërfaqe prej 36,5 ha. Ky territor përbëhet nga 286 ngastra kadastrale dhe kufizohet me:

- në perëndim me kodrën “Moronicë” dhe lumen Erenik, duke përfshirë shtratin e tij;
- në veri-perëndim me lagjen “Gacafer”;
- në veri me lagjen “Bajraktar” dhe territorin e shkollës fillore dhe të mesme;
- në lindje me lagjen “Krasniq”;
- në jug me rrugën qendrore të lagjes “Berishë”.



Fig.1 Zona e qendrës – Junik / Zona e aplikimit të planit rregullues urban

## 1.5 Qëllimet strategjike

Strategjitet e zhvillimit që prekin zonën në studim të PRRU-së, të nxjerra nga procesi i Vizionimit, mbajtur në Ohër në tetor 2007 dhe të transmetuara edhe nëpërmjet PZHU, janë:

### **1. Mbrojtja dhe evidentimi i trashëgimisë natyrore dhe kulturore**

Bazuar në vlerat e evidentuara të trashëgimisë kulturore, historike dhe natyrore objektivi i kësaj strategje është të evidentojë dhe të vendosë në eficiencë resurset ekzistuese, t'i përfshijë ato në procesin e planifikimit duke siguruar vazhdimësinë e konservimit dhe transmetimin e vlerave që ato bartin. Të promovojojë këto pasuri dhe të japë direktiva për përdorimin e tyre në funksion të turizmit historiko-kulturorë, turizmit natyrorë dhe agroturizmit.

### **2. Dendësimi i planifikuar dhe zhvillimi infrastrukturorë**

Zhvillim i ambientit të ndërtuar drejtuar nga shfrytëzimi me eficiencë i territorit urban, brenda kufirit ekzistues të ndërtimeve me qëllim kompaktësimin e tij. Dendësimi i qendrave të banuara ekzistuese duke respektuar strukturën shoqërore dhe identitetin e komunitetit banues. Zhvillimi i infrastrukturës bazë: rrugë, ujësjellës, kanalizime, telekomunikacion, si përgjigje ndaj nevojave ekzistuese dhe zhvillimeve të parashikuara.

### **3. Zhvillimi i aktiviteteve dhe shërbimeve shoqërore**

Fuqizimi dhe promovimi i jetës në komunitet nëpërmjet ndërhyrjeve në strukturën e shërbimeve. Përforcimi i hapësirës publike dhe integrimi me funksionet komunitare. Krijimi i poleve rikreative me influencë urbane, si elemente integrimi dhe socializimi ndërmjet komuniteteve.

### **4. Zhvillimi i ekonomisë**

Zhvillimi ekonomik synon fuqizimin e sektorit privat. Promovimi i aktivitetit tregtarë, krijimi i organizmave të funksioneve si dhe pajisjeve ndihmëse që lidhen me to, është një nga elementet e rëndësishëm për ekzistencën e qendrës urbane. Ruajtja e strukturës së ekonomive të vogla familjare, krijimi i kushteve për zhvillimin e tyre janë në simbiozë<sup>1</sup> me zhvillimet e tjera qytetare.

## II-PROFILI I GJENDJES URBANE

### 2.1 Zhvillimi historik i qendrës urbane

Juniku shtrihet në pjesën veriperëndimore të luginës së Rrafshit të Dukagjinit, territor i njohur për pasuritë natyrore dhe bukuritë peisazhistike.

Sa u përket zhvillimeve historike, është ndër vendbanimet më të vjetra të Kosovës. Toponimet si: Gradina, Kishza, gunga e Badrës, Kroj i Priftit, Livadhi i Madh, Gropa e Amonit, Guri i Likershit, Metapela etj., na shpiejne në rrënje të thella historike.

Lokaliteti arkeologjik “Gradina e Vogël”, shtrihet mbi qytezë, në ultësirën, në mes të lumenjëve Ereniku i Madh dhe Ereniku i Vogël, pikërisht në pjesën e sipërme të Gropës së Amonit, nën Livadhin e Madh. Gjatë shekujve me rritjen e vendbanimit dhe kalimin në ekonomi bujqësore, popullsia ka zbritur në lugine, aty ku sot shtrihet Juniku pranë fushës me të njejtin emër.

Të térhequr nga bukuritë e pakrashueshme të bjeshkëve, për këtë lokalitet janë interesuar disa studjues të huaj dhe vendas, si: A. Boe, J. Han, A Evans, F. Konica, J. Jastrebov etj. Në periudhën romake, shek. III-IV, tek Tit Livi gjemjë tri lloje vendbanimesh si: Urbes, Oppida dhe Castella. Kërkimet e deritashme kanë dokumentuar vetëm prezencën e një grupei fortifikimesh të mirëfilita iliro-romake, si në Bushat (Kukës), Pejë (Kostrumi i Pejës) dhe Gegje afër Gjakovës, dhe sipas gjetjeve në vendbanimin e parë, Juniku i përkiste këtij grupei fortifikimesh .

Sipas J.A.Evans, supozohet se në Dukagjin ka ekzistuar një Municip (komunë), një degëzim tjeter i rrugëve të brendshme të kësaj pjese që lidhte Tropojën e Dukagjinin. Përveç luginës së Drinit të Bardhë, është konstatuar se kanë ekzistuar vendbanime me origjinë nga periudha e bronzit dhe hekurit edhe përgjatë rrjedhës së lumbit Erenik, , të cilat vazhduan jetën e tyre pa ndërprerje edhe në shekujt e parë të sundimit turk. Këtu mund të përmendim Gradinën e cila përmendet nga disa historianë dhe udhëtarë.

Në vitin 1485 Juniku përmendet si nyje tregtare me 52 shtëpi. Ishte territor nën sundimin e perandorisë Otomane dhe ku rezulton që xhamia e parë duhet të jetë ndërtuar rreth vitit 1570 e që quhet “Xhamia e Çokut”, ekzistuese edhe sot. Në këto vite Juniku përmendet si një qendër tregtare më të njëjten rëndësi me Gjakovën për rajonin e Rrafshit të Dukagjinit.

Element thelbësor për vendvendosjen e qytetërimit është lumi Erenik i cili rrjedh nga masivet malore të Alpeve Shqiptare drejt jugut, për t'u bashkuar me Drinin e Bardhë. Duke ju referuar morfolologjisë urbane te sotme dhe dokumentave për zhvillimin e vendbanimeve përreth, është kryer një analizë rreth formimit të qytezës, duke ju referuar elementeve të cilat kanë pozicionuar dhe orientuar zhvillimet urbane në histori. Kjo është një tentativë për të shkruajtur kompleksitetin e kodit gjenetik të kësaj qendre urbane, duke besuar në rëndësinë e interpretimit të tij për zhvillimet e së ardhmes.

Lagjet më të vjetra të Junikut sipas dokumenteve të shkruara janë lagija Hoxhaj dhe lagja Berishë. Ky pohim vërtetohet nga meterialet historike të shkruara dhe nga arkeologjitet urbane më të hershme, të shprehura në formën tradicionale të kullave për banim.

Sikurse pohojmë edhe më sipër Juniku është një vendbanim me origjinë tregtare. Itineraret tregtare dhe kryqëzimet midis tyre, historikisht janë lidhur ngushtë me morfologjinë dhe resurset natyrore të cilat kanë mbështetur këtë aktivitet kaq të rëndësishëm në lindjen dhe zhvillimin e qytetës. Sipas prof. Spiro Kostof, në ngulimet urbane me origjinë tregtare, elemente bazë që kanë përcaktuar qendrën urbane kanë qenë kryqëzimet midis akseve tregtare në shkallë territoriale. Sheshet pranë burimeve natyrore ishin vendet e para ku njerëzit takoheshin, shkëmbnin dhe shoqërizoheshin. Pikërisht ky element urban "sheshi", kaq i rëndësishëm dhe përcaktues i identitetit urban, gjindet në bazë të procesit të qytetformimit.



Fig. 2a Zhvillimi historik i qendrës urbane

Lumi Erenik buron në viset e sipërme të Alpeve Shqiptare dhe vershon me rrjedhën e tij nëpër Rrafshin e Dukagjinit, duke vazhduar për në Gjakovë ku bashkohet me Drinin e Bardhë.

Në krahun tjetër, përgjatë aksit verilindje-jugperëndim, masivet malore të Ballkanit krijojnë një koridor tjetër komunikimi me malësitë perëndimore, Qafë Morinën. Trajektorja që kalon nëpër këtë koridor bënte lidhjen midis viseve në verilindje të Shqipërisë dhe pjesës veriore të Rrafshit të Dukagjinit duke vazhduar për në Deçan dhe Pejë. Pikërisht në këtë kryqëzim që pozicionohet përgjatë lumit Erenik, në këmbët e një kodre të butë, që duket sikur është skulpturuar nga natyra, që të shërbejë si filter ndërmjet dimensioneve madhështore të Alpeve dhe njeriut, pozicionohet sot qendra e Junikut. Kjo qendër formohet si kryqëzim ndërmjet rrugëve që lidhin Pejën, Deçanin me Batushën deri në Bajram Curr, dhe rrugës që lidh fshatrat e sipërme të grykës së Erenikut me Gjakovën dhe Prizrenin. Pikërisht në këtë kryqëzim, ndodhet objekti monumental i Xhamisë së Junikut si një dëshmitar i heshtur i formimit të qytetës.

Me ndarjen politike të kufirit pas Luftës së dytë botërore, Kosova bëhet pjesë e Federatës Jugosllave. Gradualisht me përkeqësimin e marrëdhënieve ndërmjet dy

shteteve, dobësohen edhe lidhjet organike ndërmjet viseve shqiptare në dy anët e kufirit. Në këtë kohë Juniku shëndrrohet nga një nyje lidhëse, pjesë e trajektoreve ndërkufitare, në një qytezë periferike e spostuar nga akset strategjike të zhvillimit. Shkëputja e lidhjeve me krahinat përtej Alpeve kushtëzoi një vartësi absolute të qytezës ndaj rrugës magjistrale Pejë-Gjakovë dhe qyteteve qe ajo lidh. Juniku kthehet në një aneks apo pikë fundore, pa vijueshmëri territoriale. Ky devijim që pa hezitim mund të quhet politik, pasqyrohet qartë edhe në anatominë e sheshit të qendrës. Dallohet qartë shmangia që i bëhet sheshit historik të Xhamisë së Junikut në anën verilindore.



Fig. 2b Qendra Urbane

Pozicioni i rëndësishëm gjeografik i Junikut, ka krijuar kushte për zhvillimin e vendbanimit përgjatë shekujve dhe përçon edhe në ditët e sotme kodin gjenetik strukturues, që dikton zhvillimet e së ardhmes.

## 2.2 Lidhja e qendrës me rajonin

Akset kryesore të cilat lidhin Junikun me qytetet dhe fshatrat fqinje, përbëjnë radialet kryesore që përshkojnë territorin e qendrës.

Duke pasur parasysh që rrugët në Junik nuk kanë ende një emër zyrtar atëherë, me dëshirën e mirë për të shmangur çdo keqkuptim, është preferuar të bëhet një emërtim i tyre, thjeshtë përfshirë referimi brenda këtij studimi.

Në lindje, rruga regionale Junik-Voksh-Deçan bën lidhjen me rrugën magjistrale Pejë-Gjakovë që çon në Deçan dhe Pejë. Në jug-lindje rruga regionale Junik-

Rastavicë lidhet përsëri me rrugën Pejë-Gjakovë nga ana e Gjakovës. Akset e mësipërme, duke ju referuar matjeve të bëra për fluksin e trafikut mbartin ngarkesën më të madhe të lëvizjes.

Ruga regionale Junik-Dobrosh-Gjakovë lidh qendrën me fshatrat e pjesës jug-lindore duke vazhduar për në Gjakovë. Rruga regionale Junik-Batushë bën lidhjen me fshatrat malore në jug-perëndim të tij dhe me qytetet e Shqipërisë se Veriut, ndërsa rruga Junik-Jasiq bën lidhjen me fshatrat e sipërme të grykës së Erenikut, Gjocaj dhe Jasiq duke kaluar nëpër lagjet Gacafer dhe Pepsh.



Fig. 3 Lidhja e qendrës me rajonin

Për vetë organizimin radial të rrjetit rrugorë, në Junik vihet re mbingarkesë e qendrës nga trafiku i motorizuar përfshirë makineritë e tonazhit të rëndë apo edhe ato bujqësore. Janë verifikuar disa pika konflikti me këmbësorët, për këtë shihet e nevojshme krijimi i mundësisë për bajpasimin e qendrës nga trafiku tranzitor.

## 2.3 Lidhja e qendrës me territorin urban

Juniku është një qytezë në një fazë zhvillimi ku baza fisnore është ende evidente, si në aspektin shoqëror ashtu edhe në atë fizik të ambientit të ndërtuar. Përbëhet nga 12 fise, të shpërndara në lagje në formë satelitore rreth qendrës urbane. Rruga

Junik-Batushë dhe Junik-Ponoshec lidh qendrën me Lagjen Berishë e cila gati përfshihet në të. Rruga Junik-Jasiq bën lidhjen me lagjen Gacafer dhe Pepsh të cilat zhvillohen linearisht përgjatë saj. Rruga Junik-Voksh bënë lidhjen me Lagjen Bajraktari dhe Pepsh, ndërsa rruga Junik- Rastavicë lidh qendrën me Lagjet Krasniq, Miroc dhe Gaxherri i Sipërm dhe i Ulët.

Sikurse vihet re lidhjet midis lagjeve përgjithësisht bëhen nëpërmjet akseve kryesore regionale apo lokale, duke paraqitur mungesa në rrugët apo rrugicat e rendit të tretë për komunikimin ndërmjet fqinjësisë duke ulur seriozisht fluiditetin e lëvizjes brenda territorit të qendrës. Ky fakt ndikon edhe në rëndimin e trafikut në brendësi të qendrës.



Fig. 4 Lidhja e qendrës me territorin urban

Lidhjet midis lagjeve dhe qendrës përbëjnë elemente-koridore të rëndësisë vitale për zhvillimin e jetës urbane. Përveç rolit kyç të térheqjës se flukseve në qendrën urbane, këto akse njëkohësisht bëjnë dhe unifikimin e territorit duke rritur aksesibilitetin dhe përdorimin e funksioneve qendrore.

Përparësia e këmbësorëve dhe mjeteve lëvizëse me impakt të ulët ambiental, shëmangia e trafikut të rëndë, krijimi i koridoreve urbane të pëlqyeshme dhe te sigurta, duhet të përbëjnë çështje thelbësore për t'u trajtuar në zhvillimet e ardhshme.

### III. ATRIBUTET FIZIKO-GJEOGRAFIKE

#### 3.1 Klima

Lartësia e Junikut shkon nga 367 deri në 650 metra mbi nivelin e detit. Ai shtrihet në një gjerësi gjeografike prej 42,22° dhe një gjatësi gjeografike prej 20,26°.

Në Junik mbizotëron klima kontinentale, e përzier me tipare mesdhetare. Lëvizshmëria e temperaturave është relativisht e madhe. Mesatarja e temperaturave të larta është 21 °C (në verë), kurse e temperaturave të ulta -11 °C (në dimër).

Reshjet mesatare të shiut janë 670 mm, ndërsa nga prilli deri në nëntor kjo mesatare është afersisht 330 mm.

#### 3.2 Hidrologjia

Juniku është një qytezë me pasuri hidrologjike të shumta. Lumi Erenik, që buron nga Alpet dhe vazhdon deri në Gjakovë, ku bashkohet me Drinin e Bardhë, është baza për zhvillimin e jetës në këtë vendbanim. Ai përshkon territorin e qendrës dhe përfshihet në pjesën perëndimore të saj. Ereniku përshkruhet si një lum i paparashikueshëm, me vërvime të papritura në sezonë reshjesh.

Nëpërmjet devijimit që i bëhet ujit të Erenikut në pjesën e sipërme të rrjedhës, janë formuar disa jaze (vija uji) të cilat përshkojnë territorin e qendrës që në periudha historike të hershme. Jazet përbëjnë elemente thelbësore për zhvillimin e jetës në këtë vendbanim. Uji që devijohej nga Ereniku shërbente për përdorime familjare, vënien në funksionim të mullinjëve, sharrave apo punishteve të vogla duke vazhduar drejt fushave për përdorime bujqësore.

Gjithashtu nuk mund t'i lëmë pa përmendur vlerat estetike dhe anestetike që përmbajnë këto vija uji që gurgullojnë përgjatë korridoreve duke freskuar rrugicat e gurta.

Në lagjen e Hoxhajve ekziston një krua historik, "Kroni i Hoxhajve" që buron në brëndësi të zonave të banimit në verilindje të qendrës, përshkruhet nga banorët si burim i pashterrshëm, me ujë të freskët dhe të kulluar.

Nuk ekzistojnë dokumente mbi përqëndrimin e ujërave nëntokësore.



Fig.5 Hidrologjia

Në informacionet e marra nga komuna e Junikut, është vënë theksi mbi regjinin e ç'rregullt të lumbit Erenik. Prurjet në muajt me shira, si dhe prurjet maksimale çojnë në rritje të konsiderueshme të shtratit të tij, me rrjedha të rrëmbyeshme. Për këtë arësy, duke marrë parasyshë edhe indikacionet që jepen në PZHU, këshillohet të bëhet një studim i detajuar i kësaj çështjeje si dhe të parashikohet një zonë e mbrojtur përgjatë shtratit të tij që duhet të merret parasyshë edhe nga ky plan.

### 3.3 Topografia

Qendra e Junikut përgjithësisht karakterizohet nga një topografi planare me pjerrësi të lehtë në drejtimin e luginës, veriperendim-juglindje. Pjerrësia e truallit nuk kalon shifrat 10%. Nga vëzhgimi i bërë në terren, territori i qendrës përgjithësisht karakterizohet nga një pjerrësi e favorshme për ndërtim, ku nuk duken të nevojshme parashikimet e veçanta për vendosjen e objekteve mbi truall të pjerrët.

Kemi një ulje më të shpejtë përgjatë bregut të lumbit në pjesën sipër rrugës për Batushë ku duket se topografia ka diktuar regjin e ndarjes së pronësisë dhe vendosjen e objekteve.




Fig. 6 Topografia

Këshillohet që Komuna të marrë masa për kryerjen e rilevimit të qendrës, dhe të kryejë plotësimet në planin e kuotimit.

## IV. ATRIBUTET KULTURORE

### 4.1 Analiza e pronësisë

Në Junik mund të dallojmë tri tipe pronësie : private, komunale dhe nën AKP (Agjencia Kosovare e Privatizimit).

**Prona private** karakterizohet nga një konformacion i çrregullt me parcela të formave dhe madhësive nga më të ndryshmet. Brenda territorit të qendrës mund të dallojmë parcela minimale 200-300 m<sup>2</sup> dhe maksimale 6000-7000 m<sup>2</sup>.

Në një vështrim të përgjithshëm mbi formën dhe organizimin e pronësisë, dallojmë dy konformacione gjeometrike kryesore të cilat ndahen nga rruga Junik-Jasiq dhe Junik-Gjakovë. Në perëndim të saj ka tendenca të formimit të rrjetit linearë/kuadratik me dy drejtime përafërsisht ortogonale që respektojnë vijën e lumenjtë Erenik si element kryesorë organizues. Në pjesën lindore të po këtij aksi, vihet re tendeca e organizimit rreth qendrës në menyrë radiale duke respektuar rrjetet rrugore.

Për sa i përket sipërfaqës së parcelave, përgjithësisht parcelat e fragmentuara imët gjendën pranë akseve kryesore, por ky rregull ka edhe përashtime të konsiderueshme. Parcelat e mëdha brenda territorit urban reflektojnë mënyrën e ngulimeve të veçuara me dendësi të ulët. Lidhja e ngushtë me ekonominë bujqësore si dhe struktura e përgjithshme shoqërore e zhvilluar me fise te veçuara, kanë penguar fragmentimin e mëtejshëm dhe dendësimin e truallit urban në vite.

**Pronat komunale** brenda territorit të qendrës janë relativisht të pakëta. Gjenden përgjatë rrugës Junik-Rastavicë, në pjesën veri-lindore dhe veri perëndimore të sheshit të qendrës. Për vetë situatën tranzitore, aktualisht prona publike në Junik nuk është vënë në eficence të plotë, ndërkohë që verifikohet një rritje e kërkuesës për shërbime dhe ambiente publike.

**Pronat nën AKP** janë ish prona shtetërore në proces ndërrimi të pronësisë. Këto sipërfaqe shtrihen kryesisht përgjatë lumenjtë Erenik dhe në pjesën veriore të qendrës. Për vetë statusin tranzitorë që përfaqëson ky tip pronësie, mund të përbejë një potencial për përdorimin e saj në shërbim publik ku shikohet oportune.



Fig. 7 Shpërndarja e pronësisë në zonën e qendrës

Azhornimi i kufinjëve të parcelave duke u bazuar në dokumentat kadastrale, duhet parë me prioritet nga komuna.

Pronat e pafragmentuara në brendësi të qendrës përbëjnë potencial të konsiderueshëm pér rritjen e dendësisë dhe përforcimin e indeve urbane brenda territorit të qendrës.

Komuna duhet të nisë procedurat pér kalimin nën pronësinë e saj të pronave nën AKP dhe ti vendosë ato në shërbim të komunitetit.

## 4.2 Analiza e Rrjetit Rrugor

Rrjeti rrugor zhvillohet në mënyrë radiale nga qendra urbane në drejtim të poleve kryesore territoriale.

Juniku lidhet me rajonin nëpërmjet 5 koridoreve, katër nga të cilat janë rrugë regionale dhe një lokale e cila ngjitet përgjatë lagjes “Gacafer” duke vazhduar për në fshatrat Jasiq dhe Gjocaj. Rrugët regionale janë të asfaltuara, por jo gjithmonë të pajisura me trotuare. Vitet e fundit me iniciativë të komunës janë kryer punime për ndërtimin e trotuareve në një gjatësi prej 2 km në të gjithë zonën urbane. Gjithashtu me iniciativë të komunës ka filluar ndërtimi i një itinerari çiklistik i cili tregohet i nevojshëm për vetë shtrirjen që ka territori urban.

Vihen re gjurmë ose tendencia të kompletimit të rrjetit radial me unaza siq mund të jetë Unaza e Parë që rrethon territorin e qendrës dhe vijëzon kufirin e saj. Në brendësi të indeve ndërtimore apo “mëhallave”, pjesa më e madhe e rrugëve janë “cul de sac”, që shumë shpesh myllen para objekteve apo oborreve private.

Ndërsa në akset kryesore vihen re ndërhyrje. Në brendësi të lagjeve rrugët janë ende të pashtuara, pa trotuare dhe hapësira për këmbësorë.

Disa nga trajktoret e qendrës shoqërohen nga rrëke uji, të quajtura “jaze” që vërshojnë në drejtimin të luginës. Këto elemente kontribuojnë ndjeshëm në shtimin e identitetit të rrugëve si dhe në lidhjen me natyrën, ndonëse në disa raste përdoren edhe për transportin e ujërave të zeza.

Për sistemimin e kanalizimeve të ujërave të zeza në vitin 2007 është bërë një projekt i cili ka filluar nga zbatimi dhe mendohet të përfundojë shpejt duke rritur ndjeshëm kualitetin ambiental.

Rrjeti rrugor paraqitet i degraduar në brendësi të zonave të banimit. Karakteristikë kryesore është mungesa e fluiditetit dhe një trajtshmëria e seksioneve rrugore. Shumë shpesh vihen re ndërtimë brenda perimetrit të rrugëve që krijojnë ngërçë serioze në trafik. Qendra është udhëkryq edhe për makineritë bujqësore dhe për mjetet e tonazhit të rëndë. Në mjaft raste vihen re pikë konflikti ndërmjet këmbësorëve dhe trafikut të motorizuar.

Parkingu që zë kryesisht anët e rrugëve zhvillohet përgjithësisht në mënyrë spontane, duke krijuar shpeshherë konflikte në përdorimin e sipërfaqes dhe zënien e hapësirave të këmbësorëve.



Fig. 8 Infrastruktura rrugore

Ndërhyrjet në infrastrukturën rrugore dhe krijimi i faciliteteve për këmbësorët duhet të jetë një nga prioritetet e Komunës për 10 vjeçarin e ardhshëm duke e konsideruar këtë investim si një nga çështjet thelbësore që do të ndikojnë në zhvillimin e turizmit dhe përqasjen e vizitorëve me qytezën.

### 4.3 Analiza bosh-plot

Territori i qendrës karakterizohet nga një dendësi e ulët ndërtimi me hapësira të mëdha të pandërtuara në brendësi të indeve ndërtimore.

Sipërfaqja e ndërtuar kundrejt hapësirës bosh në territorin e qendrës është 12%. Nëse bëjmë një vëzhgim të përgjithshëm vihet re një pozicionim i ndërtimeve sipas një zone fluide që orientohet nga veri-lindja në jug-perëndim në drejtim të lumit Erenik. Për këtë vendosje të ndërtimeve kanë influencuar drejtimet historike që janë analizuar më sipër, gjithashtu edhe tendeca tashmë e njojur e ngulimeve me bazë fisnore, me ndarje të qartë të një lagjeje nga tjetra nëpërmjet hapësirave të lira.

Përgjithësisht ndërtimet pozicionohen përgjatë akseve rrugore dhe në qendrat e lagjeve ku gjenden edhe ngulimet më të vjetra. Periferitë e lagjeve janë ndërtuar rrallë apo të pandërtuara. Secila lagje për sa i përket hapësirës së ndërtuar, funksionon si njësi fizikisht e mirëpërcaktuar. Vihen re formime polesh apo miniqendrash me përkatësi fisnore në brendësi të lagjeve të cilat përbajnë energji dhe janë në fazë zhvillimi. Po në këto zona janë pozicionuar më së tepërm kllat dhe indet historike, që rrethojnë si kostelacion qendrën e qytezës.

Lagja “Berishë” është dendësuar edhe në brendësi të aksit kryesorë me rradhe ndërtimore, që paraqesin aksese të vështirësuara. Dallohen tendeca të turbullta të rregullimit sipas skemës kuadratike të cilat kanë si referencë drejtimin e lumit Erenik.

Lagja “Hoxhaj” me një rol mbizotëruesh të qendrës ka imponuar një organizim të ndërtimeve në formën e rrathëve koncentrik të drejtuar nga xhamia e Qendrës. Territori i ndërtuar në këtë rast nuk është po aq kompakt sa në rastin e lagjes “Berishë”. Ndërtimet këtu pozicionohen në formë nuklesh më të dendura me hapësira të lira të konsiderueshme ndërmjet, të cilat jepin mundësi për operacione dendësimi dhe plotësimi.

Më poshtë është bërë edhe një studim i drejtimeve dominuese dhe thurjes së hapësirave urbane ku vihet re qartë konvergimi në qendër të lagjes “Hoxhaj”, si dhe relacionimi me Lumin Erenik në rastin e lagjes “Berishë”.



Fig. 9 Hapësira e ndërtuar dhe e pandërtuar në zonën e qendrës

Dendësimi i truallit duhet të kalojë përmes kompaktësimit të qendrave ekzistuese dhe akseve rrugore. Nuklet historike përbëjnë potencial të pashfrytëzuar që nëse vihen në funksionim do të shërbejnë si pole identifikuese që ndikojnë në dendësimin e brendësive të lagjeve, duke u kujdesur për ruajtjen e strukturave shoqërore egzistuese dhe principeve të planifikimit të qëndrueshëm.



Fig. 10 Pëlhura hapësinore në territorin e qendrës

#### 4.4 Analizë e altimetrisë

Qendra e Junikut dallohet për ndërtime të ulta. Mbizotërojnë ndërtimet me 1 dhe 2 kate mbi tokë të mbuluara me çati me pjerrësi mesatare. Lartësia e reduktuar e objekteve jep ndjesinë e një qyteti në shkallë njerëzore si dhe favorizon soditjen e peisazhit malorë përreth.

Vitet e fundit si rezultat i presionit ekonomisë dhe mosliberalizimit të tregut të tokës vihen re tendenca për ndërtime të larta, me 3 dhe 4 kate të pozicionuara kryesishët përgjatë akseve urbane dhe rrëth qendrës ku janë edhe parcelat e pronësisë më të vogla.

Në brendësi të njësive përgjithësisht është ndërtuar pak dhe ulët. Ndërtesat utilitare familjare apo “pozllomet”, përbëjnë rrëth 50% të totalit të ndërtimeve duke u pozicionuar në brendësi të oborreve.

Në lindje të sheshit kryesor, lartësia e ulët e objekteve e përzier me topografinë favorizuese jep mundësi pamjeje nga fushat e Junikut në lindje.

Në koridore të formuara, rrëth qendres dhe pergjate akseve kryesore, përgjithësisht dallohen perde/fasada ndërtimore të vazhdueshme me lartësi homogjene, tek tuk te paplotesuara që favorizojnë shikimet e pejsazhit.



Fig. 11 Etazhiteti i objekteve në zonën e qendrës

Duhet ruajtur lartësia dhe dimensioni human i objekteve brenda territorit të qendrës. Ky kusht do të favorizojë dendësimin dhe shfrytëzimin me eficient të truallit urban si dhe do të ruaj karakterin ruralo-urban si veçanti të qytesës. Plani gjithashtu, duhet të kufizojë lartësinë e ndërtimeve rreth objekteve të trashëgimisë.

#### 4.5 Morfologjia urbane dhe tipologjitet e ndërtimit

Gjatë luftës në dhjetëvjeçarin e kaluar, Juniku pësoi dëmtime të mëdha në trashëgiminë ndërtimore. Rreth 90% e objekteve u sulmuan dhe u shkatërruan tërësisht apo pjësërisht.

Në ditët e sotme gjurmët e konfliktit perveç se në memorien e banorëve, në panoramën urbane pothuaj nuk ndjehen më. Një aksion i vrullshëm rindertimi filloj drejtëpërdrejtë më pas, i cili në këto 10 vite la gjurmë të thella, duke ndryshuar në mënyrë radikale ambientin e ndërtuar. Për vetë shpejtësinë e ndërhyrjeve, tranzisionin që kaloi administrata lokale si dhe ndikimin e pashmangshëm të kulturës globaliste, organizmi urban pësoi alterime të konsiderueshme. Tipologjitet tradicionale, ndërtimet e gurit me mure mbajtëse, çatia me strehë të reduktuar u

zëvendësuan me ndertime moderne me konsola të dala dhe çati të banueshme. Vihet re një influencë e theksuar prej tipologjive rurale te Evropes Veriore.

Pavarësisht ndryshimeve fizike, miksimit të trendeve dhe tipeve, që në këto raste emergjente përparojnë më shpejt se sa ndryshimet në vetë kulturën shoqërore, vihet re një lloj konservatorizmi përsa i përket mënyrës së organizimit të jetës dhe ambientit urban në përshtatje me të. Në brendësitë e ishujve ndërtimet dy katëshe me oborr, të shoqëruara me objektet utilitare “pozllomet” janë tipologjia më e përhapur. Muret e larta qe rrethojnë hapësirën private duket se janë pjesë e pandarë e imazhit urban të Junikut.

Megjithë ndërhyrjet ekzistencialiste që erdhën si rezultat i konfliktit, mjeshtëria junikase e shquar në punimin e materialeve të zonës si gurit dhe drurit ka ndikuar në mënyrë të konsiderueshme në ruajtjen e memories qytetare me elemente të risjellë nga tradita ndërtimore vendase.

Kulla Dukagjinase, me vlera të pakontestueshme arkitektonike dhe shoqërore, një miks tipologjik midis objektit për banim dhe kështjellës për mbrojtje, përbën ndoshta një nga shembujt ndërtimorë më autokton në trevat shqiptare veriore. Në Junik dikur, kullat karakterizonin siluetën e vendbanimit, ndërsa sot shfaqet me disa ekzemplarë të veçantë me moshë 200-300 vjecare që përmbyjnë vlera të jashtëzakonshme historike.

Me poshtë po citojmë disa rreshta nga Dr.Fejaz Drançolli, që përshkruajnë këtë tipologji:

*“...Kulla si banesë a fortësë familjare ekzistenciale me bazë këndëdrejtë, dy, tri e rrallë herë katër katesh (sipas njësimit në popull) kishte edhe funksione të caktuara. Në përdhese ishte ahuri për strehimin e kafshëve, në kat “shtëpia e zjarrit” dhe qilarët që shfrytëzohen nga anëtarët e familjes, kurse në atë më të lartin “Oda e burrava” ose e mysafrëve. Kjo kullë, pos funksionit të banimit dhe të mbrojtjes në rast nevoje, kishte edhe dedikime të tjera. Oda e burrave luajti rolin e një institucionit me rëndësi të veçantë historike, shoqërore, politike, ekonomike, kulturore, juridike, arsimore etj...”*

Përveç tipologjive historike elitare mund të përmendim edhe objekte me karakter më populor por që përsëri mbartin vlera dhe informacione të vlefshme historike. Rreth shekullit të XIX-të filloi të përhapej një tipologji tjeter ndërtimore, e ashtuquajtura “shtëpi guri”, me ekonomike se kulla dhe më e hapur me dritën. Është i favorshëm rasti i lagjes “Berishë”, rruga e Gacaferëve, lagjja “Hoxhaj” në hyrjen nga Deçani, ku objektet e gurit ruajnë ende karakteristikat e organizmave historik. Vitet e fundit ka një lëvizje pozitive drejtuar nga konservimi, rikonstruimi dhe vënia në funksionim e objekteve me vlera për trashëgiminë.

Ndërtimet e reja në përgjithësi nuk shfaqin tendencia respektimi të proporcioneve, elementeve apo materialeve të tipologjive tradicionale. Në shumë raste vihen re alterime drastike të vazhdimësise duke modifikuar njësinë e fragmentimit, lartësinë e katit, dimensionin e hapjeve apo mbulesën e objektit. Ndërkohë mund të gjemë edhe ndërhyrje interesante siç është rasti i zëvendësimit të perdes ndërtimore në krahun e djathtë të rrugës Junik-Batushë që lidh qendrën me lumin Erenik. Objekti i ri pavarësisht trajtimit me ndikime klasiciste, respekton

morfologjinë e terrenit, tipologjinë e objektit miks, njësinë e fragmentimit të fasadave si dhe prezanton cilësi ndërtimore.

Përsa u përket tipologjive ndërtimore ekzistuese në zonën e qendrës së Junikut, mund të dallojmë tre tipe: "objekte në linjë", "objekte në radhë", "vila individuale me oborr". Ky emertim simbolik pershkruhet ne tipologjite e propozuara.

Në qendër të Lagjes Hoxhaj, përgjatë rrugëve Junik-Voksh-Deçan, Junik-Batushë, Junik-Rastavicë si rezultat i pozicionimit të funksioneve tregtare, rruga dhe interesit për shtrirje përgjatë saj ka influencuar zhvillimin e tipologjive *në linjë* me përdorim miks tregti dhe banim. Lartësia mesatare që karakterizon këto koridore është 2 kate. Në Lagjen Berishë, më e dendur me ndërtime, përveç tipologjisë së banesës individuale me oborre të reduktuara, ka edhe raste të tipologjisë *në rradhë*. Kjo tipologji në Junik karakterizohet nga fronte të gjëra dhe thellësi objekti mesatare. Raste të ngjashme vihen re edhe në pjesen veriore të lagjes së Hoxhajve. Gjithsesi kjo tipologji ende shfaqet në fazën e saj fillestare por mendohet që do të zhvillohet edhe më tej me rritjen e kërkesës për ndërtim në qendër.

*Ruajtja e tipologjive ndërtimore lokale dhe zhvillimi i tyre si përgjigje ndaj kërkesave në rritje të shoqërisë bashkëkohore është një nga sfidat më të mëdha që duhet të kalojë një vendbanim i cili kërkon të shtresëzojë dhe jo ta zëvendësojë historinë.*

*Me qëllim ruajtjen e një ambienti urban homogjen me cilësi hapësinore të mirëpërcaktuara, duhet bërë kujdes në kontrollin dhe dimensionimin e ndërtimeve të reja. Mësimi i kujdeshëm i funksioneve, evitimi i bizneseve të mëdha në brendësi të territorit urban, kontribuojnë në mirëqenje dhe zhvillim të turizmit.*

*Duhet evitar ndërtimi i objekteve me mbulesë të sheshtë i cili është në kontrast të thellë me tipologjitetë lokale të ndërtimit. Njësia e fragmentimit të perdeve ndërtimore është përsëri një element i rëndësishëm në ruajtjen e shkallës njerëzore të ambientit të ndërtuar. Dimensioni, tipi, ritmi i hapjeve (dritareve) është përsëri një faktor i rëndësishëm që mund të fortësojë apo dobësojë konceptin e vazhdimësisë së perdeve ndërtimore.*

*Duhet promovuar puna e mjeshtreve dhe artizanëve lokal me dijet që janë përçuar ndër breza si dhe duhet siguruar transmetimi i tyre në brezat e rinj.*

#### 4.6 Përdorimi i truallit dhe i objekteve

Qendra është pasqyrë e aktivitetit dhe stadir të zhvillimit shoqëror të një vendbanimi. Analiza e funksioneve dhe aktiviteteve për qendrën e Junikut përcakton tipin dhe përqëndrimin e funksioneve brenda territorit të qendrës. Nuk bëhet fjalë për influencë që kufizohet vetëm brenda kufirit nën studim. Funksionet qendrore kanë një rreze shërbimi të rangut urban dhe ndoshta territorial.



Fig. 12 Përdorimi i truallit në zonën e qendrës



Fig. 13 Funksionet e objekteve në zonën e qendrës

Hapësira urbane sipas përdorimit është klasifikuar në këtë mënyrë:

- *Hapësirë banimi* - përfshinë objektet për banim, oborret dhe ambientet utilitare. Kjo hapësirë zë pjesën dërmuese të sipërfaqes nën studim duke u përqendruar përgjatë rrugëve dhe në brendësi të njësive. Duke pasur parasysh përbajtjen rurale, hapësira brenda oborreve përmban edhe objekte apo kthina të shfrytëzuara për ekonomi familjare. Rritja e kafshëve dhe shpezëve si dhe përdorimi për bujqësi apo pemëtari i kopshteve brenda territorit urban, janë faktorë dominues të lidhur ngushtë me kulturën e vendit.
- *Hapesirë e pandërtuar* - përmban ngastra kadastrale të cilat aktualisht nuk përdoren për ndërtim. Hapësira e pandërtuar brenda territorit urban zë një sipërfaqe të konsiderueshme. Përdoret kryesisht për bujqësi, frutikulturë, kullotë, sipërfaqe për magazinim materialesh, dhe një sasi e konsiderueshme e lënë djerrë.
- *Hapësira me përdorim miks* - përgjithësisht janë të pozicionuara në perimetrin e akseve më të trafikuara. Termi miks nënkupton përdorime dinamike të hapësirës dhe ambienteve. Funksione të përziera si biznes në katin përdhe, banim apo magazinim në katin e parë. Akset e vazduhuara me funksione miks janë ende të pa konsoliduara. Vihet re tendenca për organizim në formë rruge tregetare rrëth sheshit të qendrës duke u zgjatur drejt lumit Erenik dhe rrugës për në Deçan. Ndërkohë që hasen edhe ndërprerje të shumta me mure oborresh që tregojnë mbyllje në hapësirën private. Ky fakt është derivat i tipologjive tradicionale të ndërtimit, ku pozllomi me përdorim nga brenda oborrit privat shtrihet përgjatë aksit rrugorë. Këto mure të vazduhuara dhe të mbyllura nga publiku, ndërpresin vazhdimesinë e koridorit tregtarë dhe krijojnë trajktore monotone. Fasadat e objekteve tregtarë, edhe si rezultat i teknikave ndërtimore të përdorura, kanë hapje të rralla dhe të vogla. Për sa i përket bizneseve në brendësi të zonave të banimit, përgjithësisht janë të vendosura në mënyrë pikësore dhe kanë një rreze të vogël shërbimi, siç është rasti i rrugës që kalon përmes lagjes Berishë ku mund të numërojmë 2 – 3 të tillë.
- *Hapësira publike*: përfshin pronat komunale, dhe prona të tjera jo private. Duke ju referuar statusit urban që ka qendra e vendbanimit, shtrirjes dhe numrit të banorëve, mund të themi që hapësirat publike janë të pakta dhe të pakualifikuara si të tillë. Gjithashtu në disa raste, sikurse na eshte komunikuar, ka konflikte per titullin e pronësisë.  
Pronat komunale pozicionohen rrëth sheshit të qendrës dhe përgjatë koridorit lumor. Pozicioni i tyre është tepër strategjik, dhe aktualisht në parcelat publike të qendrës ndodhet rajoni i policisë, shtëpia e shëndetit, posta. Disa nga këto hapësira si p.sh. ajo përgjatë rrugës Gacafer përbajnjë objekte të pashfrytëzuara apo të rrënuara dhe të pashfrytëzuara. Objekti i

kooperativës përgjatë rrjedhës së Erenikut është një pikë referimi me potencial për përbajtje shoqërore.

Në brendësi të qendrës nuk gjejmë objekte për arsimin. Menjëherë në kufi me të dhe përgjatë rrugës Junik-Deçan gjendet shkolla e arsimit të ulët dhe të mesëm e cila aktualisht mbulon nevojat për të gjithë territorin urban. Përsa i përket arsimit parashkollorë nuk kemi të dhëna specifike, ndërsa mendohet se këto nevoja plotësohen nga shtëpiaket apo organizime private.

Në kufi me lagjen "Krasniq", brenda territorit të qendrës në buzë të rrugës ndodhet një varrezë. Duke ju referuar propozimit të PZHU për spostimin e varrezava nga territori urban dhe grupimin e tyre në një lokacion të përbashkët, trualli që përfitohet mund të shtojë ndjeshëm sipërfaqen në përdorim të publikut.

*Miksimi i papërshtatshëm i përdorimeve të hapësirës sikur rasti i blektorisë me banimin apo me shërbimet shumë shpesh komprometon funksionimin e rregulltë të secilit aktivitet.*

*Dimensionet e reduktuara të rrugëve, përdorimi i tyre nga automjetet e tonazhit dhe makineritë bujqësore, krijojnë pika konflikti me funksionet e biznesit të vendosura përgjatë tyre.*

*Ndërprerja e akseve me funksion biznesi, mbyllja e fasadave nga rruga ndikojnë negativisht në imazhin urban dhe qasjen e turistëve më qytezën.*

*Zonat për tregtimin e materialeve inerte apo edhe i shërbimeve të oficinave të automjeteve në brendësi të qendrës urbane, favorizojnë trafikun e tonazhit të rëndë, bëhën qendra zhurme dhe ndotjeje.*

*Venia në eficënsë e parcelave publike, prona të komunës është një faktor i rëndësishëm që influencon në mënyrë të drejtpërdrejtë shtimin e shërbimeve.*

## 4.7 Analiza e trashëgimisë kulturore dhe historike

Juniku është një vend i cili jeton i lidhur ngushtë me traditën. Vetë struktura e tij shoqërore e përbërë prej grupeve me përkatësi fisnore, favorizon transmetimin e traditës. Ndërkohë që organizimi urban me lagje te vecuara, me shume qendra, ka ndikuar në fenomenin e shpërndarjes së objekteve me vlera dhe jo përqëndrimin e tyre.

Me vrullin e zhvillimit që sjell jeta moderne, gjithnjë e më tepër rrezikohet kjo pasuri e trashëguar brez pas brezi. Papërshtatshmëria e objekteve tradicionale prej guri me mënyren e jetesës dhe komoditetin që kërkon sot njeriu global, ka sjellë braktisjen e tyre dhe degradimin e vazhdueshëm. Sigurisht këtu duhen përmendur edhe kostot për mirëmbajtjen dhe restaurimin që shkojnë kundër çdo logjike tregu.

Përveç fenomenit praktik të mësipërm, gjatë konfliktit të viteve '98-'99, kulla Dukagjinase u konsiderua si kështjellë e qendresës qytetare shqiptare duke u sulmuar sistematikisht. U verifikua fenomeni i "urbicidit" duke konsideruar objektin si armik dhe si rrjedhojë pason shfarosja e tij. Informacionet nga tereni tregojnë se rreth 98% e objekteve u dëmtuan, dhe sidomos kullat dhe objektet e trashëgimisë, me tendencë çrrënjosjen dhe turpërimin e çdo shënje të shqiptarisë. Kjo tregon nevojën dhe detyrimin për të ruajtur këto objekte dhe për ti projektuar drejt së ardhmës, drejt brezave që do të vijnë, si dokument që nuk ka të bëjë me arsyë praktike ekzistencë. Bëhet fjalë për monumente të mirëfillta shqiptare.



Fig. 14 Kulla "Oda e Junikut", Junik

Më poshtë po citojmë një pjesë të marrë nga "Rrënimi i kullës shqiptare", të Dr. Sc. Fejaz Drançollit, ku përveçse trajtohet më imtësi kulla si objekt banimi etnik, detajohet dhe procesi i formimit të ansambleve të kullave si bërthama të lagjeve në Junik.

...Ndërtimtarinë populllore kosovare, përkatësish shqiptare e pasurojnë edhe objektet e arkitekturës fshatare të banimit të tipeve dhe varianteve të ndryshme që u ndërtuan gjatë periudhës të sundimit osman. Natyrisht që objektet nga periudhat e hershme, përkatësish nga shekujt XV, XVI e XVII nuk kanë mbetur. Mirëpo duhet theksuar se, padyshim, ndërtimet e mëvonshme të realizuara nga mjeshtër lokal kanë përcjellë skemat kompozicionale të ndërtimeve të mëparme...

Juniku dallohet për punëtorinë dhe mjeshtritë, e gurit, të drurit, të hekurit-dhe më pas vazhdon:

... *Disa nga këto kulla veçohen me vlerat e tyre artistike e estetike si nga trajtimi i anës së jashtme, po ashtu edhe nga ai i anës së brendshme. Pikërisht për këtë, kjo kullë, ka një arkitekturë origjinale shqiptare. Kjo bënë që të veçohet dhe të dallohet si për skemën kompozicionale, ashtu edhe për pasurinë e elementeve të saj, forma e këtij ndërtimi nga realizimet e tipit të njëjtë jasht territorit etnik shqiptar në zonën e Gadishullit Ballkanik dhe më gjërë...*

Në rastin e Junikut, i cili në vitin 1485 njihej si *Lunik*, pjesë e Altun-Ilia Nahia (sipas regjistrat të Sanxhakut të Shkodrës) ku *Alten* do të thotë *Vend i Artë*, padyshim që objektet e arkitekturës tradicionale janë të shumta. Në territorin e qendrës gjenden 11 kulla dhe 3 mullinjë si dhe disa shtëpi guri, të cilat në vetvete nuk mbartin vlera arkitektonike të kullave por krijojnë mirë kompleks me ato. Për komplekset e kullave si banesa në Junik, F. Drançollit shkruan:

...*Juniku si fshat përbëhet prej shumë lagjeve ose mëhallave. Mëhallat kryesore, përkatësish qendrore janë: Hoxhaj, Gacafer, Berishë....Të cekim se kullat më të vjetra janë të mëhallës Hoxhaj. Këtu kemi ekzemplarë të kullave që kronologjikisht janë më të vjetrat e tipit në fjalë. Këtu na prezantohet kulla me murin e drurit të dyshekllëkut që del nga muri, muret perimetrale të objektit...*

...*Tregovishta me kullat e familjës së Hoxhajve paraqet bërthamën e kompleksit të kullave të vjetra të Junikut. Njëkohësisht duhet theksuar se ky ansambël i kullave filloj të realizohet në dekadat e fundit të shek. XVIII dhe mbaroi në fund të shekullit XIX....Lagja Hoxha*", për dallim nga të tjerat, ishte më e dendur dhe për këtë ajo dallohet në këtë aspekt nga lagjet periferike të Junikut. Karakteristikë dhe veçori përafërsisht identike kishte edhe mëalla Gacafer dhe Berishë...Tri mëhallet qendrore krijuan bërthamën e vjetër të Junikut....

...Në një periudhë mbi njëshekullorë të ndërtimit të objekteve të fortifikuara, pos kullës me mur druri të dyshekllëkut, u realizuan edhe variante të tjera të kullave: kulla me muei guri të dyshekllëkut që del nga muri, muret perimetrale si dhe kulla me mur guri të dyshekllëkut që nuk del nga muri, muret perimetrale si dhe variantet e tyre. Në Junik kishte edhe kulla me shtrirje horizontale të veçuara ose të shtuara si aneks të kullave tri katëshe...

Më pas ndalet në një nga kullat më të spikatura si përsa i përket vlerës arkitektonike ashtu edhe rëndësisë institucionale :

... "Oda e Junikut", kulla e Hoxhajve, pos vlerës konstruktive-arkitektonike, funksionale, artistike e estetike pati edhe një rëndësi të posaçme. Oda e Junikut ishte institucion juridik, shoqëror e politik. Këtu u mbajtën tubime të ndryshme me rëndësi jo vetëm për Junikun, Rekën e Keqe, por edhe për tërë Kosovën. Në Odë u morën shumë vendime me interes shoqëror, politik e juridik, aty u pleqërua, u dënuua, u pajtuan gjaqet, u zgjidhën ngatërresa të ndryshme të junikasve dhe më gjërë. Oda

*kishte 12 odabash nga të gjitha mëhallet e Junikut. Me odabash kryesonte kryeplaku i Odës. Kryeplaku është zgjedhur nga 12 odabashet dhe kryesisht ky post i takonte plakut të Hoxhajve. Pra, kjo ishte pos të tjerash edhe një nga karakteristikat që e bënë kullën në fjalë edhe më të vlefshme dhe me rëndësi për historinë dhe kulturën shqiptare.*

Kjo kullë, sikurse edhe të tjera gjatë luftës së viteve '98-'99, u dëmtua rëndë. Në vitin 2001 filloi restaurimi i saj me projekt të financuar nga Agjensia Evropiane për Rindërtimin, SIDA. Implementimi i këtij projekti u bë nga grupet e specialistëve të CHWB-së. Sot "Oda e Junikut" qëndron në gjendje shumë të mirë, duke përbërë një shembull që duhet ndjekur për objektet e tjera me rëndësi për trashëgiminë kulturore në këtë vend kaq të pasur, sa edhe të harruar nga flukset turistike.

Përveç kullave dhe shtëpive prej guri objekte utilitare tradicionale janë edhe mullinjtë. Në territorin e qendrës kemi dy të tillë, njëri në lagjen "Berishë" dhe tjetri në kufi te lagjes "Krasniq". Mullinjtë kanë pasur një rëndësi të veçantë në kohët kur përdorej gjerësisht energjia e marrë nga uji. Sot mullinjtë e vjetër gjenden jashtë funksionit, por roli i tyre simbolik vazhdon të emetoje energji ne brezat e rinj. Gjithashtu muret e larta prej guri me portat e larta prej druri, janë pjesë e karakterit të vendit dhe pasqyrë e zhvillimit të artizanatit lokal.

*Ky plan duhet të integrojë në proceset e zhvillimit objektet e karakterizuara me interes për trasëgiminë kulturore sipas motos "konservim - zhvillim". Të kontribuojë në krijimin e organizmave me status të veçantë konservimi dhe t'i integrojë ato me ritmet e zhvillimit duke shmangur degradimin e tyre. Të mundësojë dhe të kontribuojë në trasmetimin e njohurive të artizanatit lokal tek brezat e rinjë për të siguruar vazhdimësinë e traditës.*

## V. PEJSAZHI

### 5.1 Lidhja ndërmjet ambientit urban dhe natyrës

Juniku pozicionohet në kufirin midis masivit të Alpeve Shqiptare dhe Rrafshit të Dukagjinit. Ky lokacion gjeografik karakterizohet nga kodrat e buta në planin e parë vizual, dhe masivet malore në plan të dytë në drejtim të veriut dhe perëndimit. Në jug dhe lindje, shtrihet Rrafshi i Dukagjinit me terren të sheshtë dhe valëzime të lehta duke ofruar pamje deri në thellësi pergjate fushave të Junikut. Territori i qendrës shtrihet mbi një truall përgjithësisht të rrafshët me rrënie të lehtë nga veriu në jug. Pozicioni i saj i ngritur jep mundësi pamje me 360°.

Në fakt në qendër të Junikut natyra është gjithëprezente. Ajo merr pjesë në jetën e përditshme të banorëve duke mbyllur çdo sfond. Në pjesën perëndimore shtrihet lumi Erenik me sistemin e tij të gjelbërimit dhe me fushat që shtrihen përgjatë tij. Menjëherë pas tij në perëndim ngrihet kodra e bukur e Moronicës e cila krijon kontrast për nga ngjyra dhe bimësia me sfondin e bjeshkëve. Asambleja Komunale e Junikut, në datë 28.08.2008 shpall Moronicën “zonë të vecantë të Komunës së Junikut”. Kjo zonë mendohet të jetë “*parku i ardhshëm i qytezës (...) që do të jetë si urë lidhëse në mes parkut etnografik dhe parkut nacional të Bjeshkëve të Nemuna*”.

Në analizat peisazhistë të cilat kanë pasur përfokus studimin e lidhjes së territorit urban më natyrën, është vëzhguar relaciioni përgjatë akseve i pjesëve të ndryshme brenda qendrës me territorin përreth. Janë përcaktuar vlerat peisazhistë, tërësitë natyrore brenda territorit urban dhe komunikimi me to përmes akseve të vëzhgimit. Gjate kësaj analize, janë seleksionuar tri tërësi hapësinore:

- a) E para e quajtur “Parku i Erenikut”, shtrihet përbri lumi Erenik në pjesën veriore në një sipërfaqe prej rreth 3-4 hektar. Kjo hapësirë prezanton një pejsazh natyrorë të virgjër me përdorime për bujqësi dhe ekonomi familiare. Flora e saj është pjesë e sistemit natyrorë të lumit Erenik. Shkurre të ulta perimetronjë shtratin e lumit dhe drunjë të lartë ndodhen në brendësi. Kjo hapësirë duhet vënë në regjim ruajtje si pjesë e rendësishme e sistemit natyrorë të Erenikut.
- b) Tërësia tjeter hapësinore është quajtur simbolikisht “Oborri i Junikut”. Shtrihet në mënyrë perpendikulare më të parën në pjesën lindore të qendrës. Është një sipërfaqe fushore në formë koridori prej rreth 2-3 hektarësh me përdorim kryesisht bujqësor dhe kullotë. Kjo hapësirë me karakter të ndryshëm nga e para perimetrohet nga të gjitha anët nga objekte banimi dhe ekonomi familiare. Në sheshin e qendrës së qytezës kjo hapësirë lejon shikim të drejtpërdrejt në fushën e Junikut dhe plotëson panoramën malore dhe fushore që karakterizon këtë vendbanim.
- c) Në pjesën jug-lindore shtrihet një sipërfaqe tjeter e gjelbërt me madhësi 3-4 ha që gati deformon kufirin e qendrës me fushën që shtrihet në pjesën jugore. Ky potencial mund të konsiderohet përritjet e mëvonshme të qendrës, në mënyrë që të krijohet një bord në formë kufiri i urbanes me natyroren. Ndërthurja e ambientit urban me natyrën në mënyrë të ekuilibruar është krijuar si rezultat i përqëdrimit të vendbanimeve në qendra

të veçuara si dhe prej dendësisë së ulët të ndërtimit. Lidhja e secilit fis me tokën dhe aktivitetin bujqësor ka krijuar një ndërthurje unike te hapësirae bosh/plot.



Fig. 15 Lidhja ndërmjet territorit urban dhe natyrës

Hapësirat si tërësi të paprekura nga ndërtimet, karakterizojnë panoramën urbane të Junikut. Tokat bujqësore dhe kullotat në brendësi të territorit urban janë hapësira thelbësore për egzistencën dhe ruajne karakter të veçantë. Ato duhen vënë në regjim konservimi. Ky operacion do të mundësojë edhe një koncept zhvillimi me kompakt të ambientit të ndërtuar.

Duhet të merret parasysh mundësia e krijimit të parkut urban të qendrës i cili do të shërbejë për rikrijimin dhe zbavitjen në natyrë të banoreve dhe vizitoreve.

## 5.2 Analizë e trajktoreve përshkuese urbane dhe poleve

Me studimin e koridoreve urbane është parë karakteri i secilit koridor në lidhje me kontaktin që ka me natyrën dhe pejsazhin përreth. Vihen re këto raste:

- *koridore të ndërtuara dendur* - me ndërtesa të ngjeshura me njëra-tjetërën dhe rrugë të ngushta. Është rasti i rrugës "Berishë", rruga Junik- Voksh-Deçan, rruga Junik- Jasiq (pjesërisht).
- *koridore të hapura* nga njëra anë - këtu futet koridori që perimetron lumin në kufi me lagjen "Berishë", rruga Junik-Jasiq (pjesërisht), rruga Junik-Rastavicë, pjesa veri-perëndimore e unazës, apo koridoret pranë tërësive hapësinore të sipërpërmendura.
- *koridore të ndërtuara imët* - me ndërtime të rralla dhe me oborre me gardhe të ulta. Kjo kategori vihet re më tepër pranë vijës që kufizon qendrën dhe pjesërisht në rrugët radiale

Ruajtja e lartësisë së reduktuar të ndërtimeve është element thelbësorë për përjetimin e natyrës në zonën urbane duke mos krijuar mbyllje të ngushta e të larta. Gjithashtu lartësia e objekteve duhet të respektojë topografinë e qendrës duke lejuar vizualat nga lumi dhe nga kodra e Moronicës.

Përqëndrimi i ndërtimeve për dendësimin e zonave urbane tashmë të ndërtuara me qëllim ruajtjen e tërësive hapësinore dhe evitimin e ndërtimeve fragmentare brenda tyre duhet të jetë një nga qëllimet kryesore të këtij plani.



Fig. 16 Pamje e qytetes së kohës mbi Morocen

## VI. KONCEPTI



Fig. 17 Koncepti i dizajnit të PRru-Junik

### Koncepti i dizainit:

Zhvillimi dhe kualifikimi i qendrës përmes dy aksesh kryesore konceptuale me referenca gjeografike dhe urbano-morfologjike. Aksi përgjatë lumbit Erenik, i quajtur "Bregu i Erenikut" që do të përbajë një seri atmosferash rekreative, që kontribojnë në lidhjen e njeriut me natyrën duke përfshirë shetitore për këmbësorë, trajektore ciklistike, një sistem parku me një seri funksionesh brenda tij që lidhet me Parkun e Moronicës nëpërmjet dy urave për këmbësorë. Aksi perpendikulare me lumin Erenik i cili grupon disa funksione dhe aktivitete duke filluar nga "Tregu (Pazari)", sheshin e qendrës, objektet administrative, kompleksin e kullave "Hoxhaj", objektet shkollorë. Ky aks është quajtur "Shetitorja e Junikut" dhe përmban në brendësi të tij funksionet, shërbimet, objektet më të spikatura dhe përfaqësuese të qytezës së Junikut. Parashikohet plotësimi me njësi tregtare, rikualifikimi i perdeve ndërtimore, shtresave, hapësirave për këmbësorë, parkimeve të automjeteve, gjelbërimin dhe ndriçimin.

Krijimi i një intenerari qe ve ne relacion episodet atraktive qe lidhen me trashigimnine kulturore si menyre efikase per te treguar "filmin e qytezes" me vlerat me te mira qe ajo permban. Rivitalizimi i zonave me interes për trashëgiminë si kulturore ashtu edhe natyrore.

## VII. OBJEKTIVAT

Bazuar në qëllimet strategjike, Plani Rregullues Urban për qendën e Junikut ka për synim të realizojë këto objektiva specifike:

- **Shfrytëzimi ekonomik dhe dendësimi i truallit urban** në qendrat ekzistuese për të rritur efikasitetin e tij përmes kompaktësimit të ndërtimeve përgjatë akseve rrugore ekzistuese Junik-Rastavicë, Junik-Batushë, Junik-Deçan, Junik-Gjakovë dhe përgjatë perimetrit të Unazës së Qendrës në segmentin veri-lindor dhe atyre të planikuara në brendësi të lagjeve, gjithashtu rivlerësimi i nuklevë katalitike, është një ndërhyrje që do të kontribuojë për këtë qëllim.
- **Krijimit të nuklevë katalitike shumëfunkSIONALE** që përbajnjë brenda tyre: kullat, shtëpitë e gurit, mullinjtë etj. të cilët do të transformohen në elementë të rëndësishëm të jetës sociale të komunitetit si bibliotekë komunale, muze etnografik, shtëpi kulture, shkollë për artizanatin, etj. Këto elemente do të synojnë jo vetëm përfocimin e identitetit të njësive strukturore të qendrës, por do të udhëheqin edhe transformimet brenda këtyre njësive si dendësimin dhe rikualifikimin.
- **Nxitja e përdorimit të përzier të truallit** përmes krijimit të itinerareve turistike, tregtare, peisazhistë që përbajnjë funksione si tregti, artizanat, argëtim. Krijimi i fashës së vazduhar tregtare, "Tregu (Pazari) i Junikut" përgjatë aksit që lidh qendrën me lumin Erenik (fillimi i rrugës së Batushës);
- **Rikualifikimi i "perdeve" ndërtimore** përgjatë aksit Junik-Deçan, rrugës "Gacaferi", rrugës përgjatë lumit Erenik, rrugës "Berishë", përmes vendosjes së kondicioneve të detajuara për fasadat e objekteve që ndodhen përgjatë tyre.
- **Venia në regjim konservimi e tërësive hapësinore** si "Parku i Erenikut", hapësirës në lindje të qendrës të quajtur "Oborri i Junikut", tokave bujqësore; vlerave pejsazhistë përgjatë lumit dhe korridoreve vizuale në drejtim të fushave dhe bjeshkëve; dhe zonave ambientale kritike si shtrati i lumit Erenik dhe gjithë fasha e përkatësisë së tij për të krijuar kushtet e një zhvillimi të qëndrueshëm;
- **Venia në regjim konservimi e trashigimisë kulturore** të zonës së kullave në lagjen "Berishë", përgjatë rrugës "Junik-Rastavicë", në lagjen "Hoxhaj" ku gjendet edhe "Oda e Junikut" dhe përgjatë rrugës "Gacafer"; integrimi i tyre me nevojat e komunitetit përmes ndryshimit të funksioneve dhe vënies në dispozicion të zhvillimeve turistike për t'i përfshirë ato në ciklet e reja të jetës;

- **Përforcimi i hapësirës publike** dhe krijimi i mundësive për jetë në komunitet përmes krijimit të hapësirave për këmbësorë, të cilat respektojnë kushtet për eleminimin e barrierave arkitektonike për personat me aftësi të kufizuara përgjatë rrugës Junik-Deçan, rrugës "Gacaferi", rrugës "Berishë"; krijimi i itinerareve të mundshme për këmbësorë që lidhin zonat turistike; krijimi i "Parkut të Erenikut" me pajisje urbane, sportive dhe rekreative, lidhjen e tij me shitetoren përgjatë Lumit Erenik dhe krijimit të lidhjeve (fluiditeti gradual) me territorin jashtë qendrës dhe jashtë zonës urbane në drejtim të parqeve dhe burimeve natyrore territoriale.
- **Krijimi i vendtakimeve dhe trajektores turistike** e cila vë në relacion "zonat e trashëgimisë" midis tyre dhe me pjesën tjeter të qendrës së qytetit si edhe bërjes së saj të "lexueshme" përmes elementeve fizike si shtresa rrugore, elemente ndriçimi dhe mobilimi urban, sinjalistikës, etj.
- **Regullimi i trafikut të motorizuar** nëpërmjet ndërhyrjeve rehabilituese, si zgjerim të rrugëve në aksin Junik-Rastavicë dhe Junik-Gjakovë; ndërtim të segmeneteve të reja si ai nga shkolla fillore në lagjen "Krasniq"; rikualifikimit të gjurmëve rrugore ekzistuese që lidhin Lagjen "Krasniq" me lagjen "Berishë", shkollën fillore me rrugën "Gacafer"; organizimi i qarkullimit nëpërmjet rrugëve njëdrejtimëshe (sense unike), sidomos në segmentet e kompletuara Junik-Deçan, Junik-Batushë, rrugës "Gacaferi", rrugës "Berishë", shenjëzimi i këtyre akseve dhe nyjeve në përputhje me planin e trafikut. Përmes favorizimit të transportit publik me ndërtimin e stacionit të autobuzëve përgjatë aksit Junik-Rastavicë në afërsi të Unazës së Qendrës.
- **Rritja e sigurisë në rrugë** përmes ridizejnimit të elementeve teknike dhe të mobilit urban të rrugëve si: trotuaret, vendosja e sinjalistikës, ndriçimi rrugor, nyjet kryesore, eliminimi i barrierave, etj. Shmangia e trafikut të rëndë dhe makinerive bujqësore brenda territorit të qendrës nëpërmjet unazës së propozuar për qendrën.

## VIII. RREGULLORJA

### 8.1 Hyrje

Kjo rregullore përcakton rregullat për zhvillimin dhe konservimin e Qendrës së Junikut sipas kufijve të paracaktuar me vendim të Kuvendit Komunal të Junik.

Rregullorja e Planit Rregullues për Qendrën, Junik vlen për të gjitha hapësirat e hapura apo të mbyllura të çdo tipi pronësie, akset e komunikimit apo parkingjet, ndërtimet e reja, rindërtimet, restaurimet apo riadaptimet. Ndërtimet e kryera me leje dhe që nuk janë në pajtim me parashikimet e këtij plani dhe me rregulloren e tij, do të mbrohen deri në momentin e rindërtimit apo riadaptimit të tyre. Periudha kohore e paracaktuar për implementimin e këtij plani është dhjetë vjeçare. Pas kësaj periudhe duhet të zëvendësohet me një dokument të ri, eventualisht të rishikohet dhe të aktualizohet.

### 8.1 Organizimi i territorit urban sipas PRrU-së

Territori urban ndahet në 20 nën-njësi urbane duke marrë parasyshë këta faktor:

- 1) strukturën shoqërore;
- 2) strukturën e pronësisë;
- 3) strukturën urbane;
- 4) strukturën ambientale.

Secila nga nën-njësitë ndahet nga tjetra nëpërmjet koridoreve rrugore apo tërësive hapësinore. Çdo nën-njësi ndërtimore përbëhet nga tipet ndërtimore që përkufizohen dhe rregullohen nëpërmjet përcaktimit të tipologjisë.

Kjo rregullore nëpërmjet rregullave të përgjithshme dhe të veçanta kufizon nën-njësitë dhe hapësirat ndërmjet tyre, brenda kufirit të qendrës.

### 8.3 Kufiri i zonës së PRrU-së

Plani Rregullues i qendrës së Junik përfshinë këto ngastra kadastrale:

1377-0; 1378-0; 1379-0; 1380-0; 1381-0; 1382-0; 1383-0; 1384-0; 1385-0;  
1386-0; 1387-0; 1388-0; 1389-0; 1390-0; 1391-0; 1392-0; 1358-0; 1359-0;  
1360-0; 1361-0; 1363-0; 1365-0; 1366-0; 1367-0; 1368-0; 1369-0; 1370-0  
1371-0; 1372-0; 1373-0; 1374-0; 1375-0; 1376-0; 2103-0; 1338-0; 1339-0  
1340-0; 1341-0; 1342-0; 1343-0; 1344-0; 1346-0; 1347-0; 1348-0; 1349-0  
1350-0; 1351-0; 1352-0; 1353-0; 1354-0; 1355-0; 1356-0; 1357-0; 1357-2  
5117-2; 2106-0; 2107-0; 2105-0; 2104-0; 2109-0; 2111-0; 2110-0; 2112-0  
2114-0; 2108-0; 2113-0; 2134-0; 2133-0; 2132-0; 2135-0; 2136-0; 2137-0  
2131-0; 2139-0; 2138-0; 2143-0; 2142-0; 2140-0; 2141-0; 2144-0; 2145-0

2146-0; 2151-0; 2152-0; 2115-0; 2124-0; 2125-0; 2126-0; 2127-0; 2128-0  
2129-0; 2130-0; 2147-0; 2148-0; 2149-0; 2153-0; 9026-0; 2116-0; 2123-0  
2121-0; 2122-0; 2120-0; 2119-0; 2118-0; 2019-0; 2021-0; 2022-0; 2024-0  
2025-0; 2026-0; 2027-0; 2028-0; 2030-0; 2031-0; 2032-0; 2033-0; 2034-0  
2087-0; 2089-0; 2090-0; 2091-0; 2092-1; 2092-2; 2093-0; 2094-0; 2095-0  
2096-0; 2097-0; 2098-1; 2098-2; 2098-3; 9015-0; 9043-0; 2102-0; 2099-0  
2100-0; 2101-0; 2037-0; 2038-0; 2039-0; 2040-0; 2041-0; 2042-0; 2043-0  
2044-0; 2045-0; 2046-0; 2047-0; 2048-0; 2050-0; 2051-0; 2052-0; 2054-0  
2055-0; 2056-0; 2057-0; 2058-0; 2059-0; 2060-0; 2061-0; 2062-0; 2063-0  
2064-0; 2065-0; 2066-0; 9045-0; 2035-0; 2067-0; 2068-0; 2069-0; 2070-0  
2071-0; 2072-0; 2073-0; 2074-0; 2075-0; 2076-0; 2077-0; 2078-0; 2079-0  
2080-0; 2081-0; 2082-0; 2083-0; 2084-0; 2085-0; 2086-0; 1963-0; 1964-0;  
1966-0; 1967-0; 1970-0; 1971-0; 1972-0; 1973-0; 1974-0; 1975-0; 1976-0  
1977-0; 1978-0; 1979-0; 1980-0; 1981-0; 9040-0; 2412-0; 2413-0; 1983-0  
1984-0; 1985-0; 1986-0; 1987-0; 1988-0; 1990-0; 1991-0; 1992-0; 1993-0  
2018-0; 5071-2; 1994-0; 1995-0; 1996-0; 1997-0; 1998-0; 1999-0; 2000-0  
2001-0; 2002-0; 2003-0; 2004-0; 2005-0; 2006-0; 2008-0; 2009-0; 2010-0  
2011-0; 2012-0; 2013-1; 2013-2; 2014-1; 2014-2; 2015-0; 2016-0; 2017-0  
9064-0; 1393-0; 1394-0; 1395-0; 1396-0; 1397-0; 1399-0; 1400-0; 1401-0  
1402-0; 1403-0; 1404-0; 1405-0; 1406-0; 1407-0, 1408-0; 1409-0; 1410-0  
1411-0; 1412-0; 1413-0; 1414-0; 1415-0; 1416-0; 1417-0; 1419-0; 1420-0  
9037-0; 1421-0; 1422-0; 1423-0; 1424-0; 1428-0; 1429-0; 1430-0; 1431-0  
1432-0; 1433-0; 1434-0; 9030-0; 9031-0; 9032-0 .

#### 8.4 Destinimi i sipërfaqeve sipas PRrU-së

Me destinimin e sipërfaqeve nënkuftohet karakterizimi sipas tipit të përdorimit të sipërfaqes urbane në territorin nën studim. Në sipërfaqe përfshihet hapësira e ndërtuar me objektet dhe ajo e pandërtuar.

Përkrimet mbi mundësitë e përdorimit janë dhënë sipas tri klasifikimeve:

- Funksione të lejuara: janë ato tipologji shfrytëzimi të hapësirës të cilat lejohen të kryhen brenda kufirit të zonës së përcaktuar;
- Funksione të kushtëzuara: janë ato tipologji shfrytëzimi të hapësirës për të cilat kërkohet një leje e veçantë përdorimi e cila merret në komunë. Për aplikimin për leje në komunë, sipas rastit është e domosdoshme pajisja me pëlqimin e fqinjëve me pronësi kufitare, mbi aktivitetin që mendohet të kryhet.
- Funksione të ndaluara: janë ato tipologji shfrytëzimi të hapësirës të cilat ndaloohen me rregullore për zona të caktuara.

Territori nën studim të PRrU-Qendër Junik është ndarë sipas përdorimit të hapësirës urbane në këto klasifikime :

- a) Sipërfaqe Banimi;
- b) Sipërfaqe Publike;

- c) Sipërfaqe e Gjelbërt;
- d) Sipërfaqe Prodhuese Urbane;
- e) Zonë me Vlera Kulturore (nën mbrojtje);
- f) Fashë Afarizmi me dendësi të lartë;
- g) Fashe Afarizmi me dendësi të ulët;
- h) Sipërfaqe Transporti;

## 8.5 Specifikimi dhe rregullat mbi përdorimin e truallit

Ky nënkapitull përmban specifikimin dhe rregullat e përdorimit te hapësirës sipas planit rregullativ. Kalsifikimet e mëposhtme dhe rregullat mbi përdorimin e truallit i referohen "Hartës së Destinimit te Sipërfaqeve". Pjesë e rregullores së PRrU-Qendër Junik janë edhe këto specifikaime:

### a) ***Sipërfaqet e Banimit*** ndahet në dy klasifikime:

- 1 - banim me dendësi mesatare (ISHP= max 45%);
- 2 - banim me dendësi të ulët (ISHP=max 35%);

Kjo hapësirë përmban sipërfaqe të destinuara për banesa sipas tipeve të përshkruara nga ky plan. Me termin banesë nënkuftohet ai objekt ku min 70% e sipërfaqes së dyshemësë përdoret për banim. Përveç banimit, sipërfaqja e mbetur e parcelës mund të përdoret për ekonomi të vogla familjare si: veprimitari artizanati (jo shqetësuese për fqinjët, jo ndotëse), aktivitet bujqësor, rritje shpezësh apo kafshësh të vogla shtëpiake. Gjithashtu është i pranueshëm, edhe pse i kushtëzuar, përdorimi i hapësirës për zhvillimin e hotelierisë-agoiturizmit duke përfshirë funksione të përgatitjes së ushqimit dhe tregtimit të tij. Në raste interesit publik hapësira e banimit mund të reduktohet edhe në 0%.

- **Funksione të lejuara:**
  - banim;
  - ekonomi familjare ;
  - shitore me pakicë;
- **Funksione të kushtëzuara:**
  - hotelieri, agroturizëm, kafeteri;
  - punishte apo veprimitari artizanale;
  - shërbime private;
  - objekte për kulturën;
  - çerdhe/kopshte;

- Funksione të ndaluara:
  - punishte riparimi të makinerive;
  - punishte apo veprimtari artizanale ndotëse të ajrit dhe ambientit;
  - punishte apo veprimtari që shkaktojnë ndotje sonore;
  - stacionet e pompave të karburantit ;
  - dyqane me shumicë apo supermarketet;

**b) *Sipërfaqe Publike;***

Ky destinacion i përket të gjitha parcelave në pronësi të Komunës. Këto parcela i destinohen përdorimeve për objekte apo hapësira në interes të komunitetit. Indeksi i shfrytëzimit të parcelës është ISHP= 70% dhe ISD= 2. Parcela komunale mund të shfrytëzohet për objekte administrative, kulturore, shkolllore, shëndetësore shërbimi për komunitetin. Për interes të komunitetit Indeksi i shfrytëzimit të parcelës në këtë rast mund të zbresi edhe në 0%.

- Funksione të lejuara:
  - objekte administrative;
  - objekte/ambiente shkolllore ;
  - objekte edukative;
  - objekte të policisë, zjarrfikësve, post telekomunikacionit;
  - objekte shëndetësore publike;
  - objekte shërbimi publik;
  - sheshe apo gjelbërim publik;
  - sipërfaqe parkimi.
- Funksione të ndaluara:
  - objekte banimi;
  - punishte prodhimi;
  - stacione e pompave të karburantit;

**c) *Sipërfaqe gjelbërimi publik***

Janë ato sipërfaqe të lira në funksion të komunitetit që shërbejnë për të sjell natyrën brenda territorit urban. Në këto sipërfaqe mund të ndërtohen vetëm objekte në funksion të komunitetit dhe të nevojave rekreative të tij. Indeksi i shfrytëzimit të parcelës në këtë rast është ISHP= 5% dhe ISD= 0,25. Lejohet vendosja e objekteve të lehta arkitektonike si tenda, instalacione, shatërvane. Lejohet përdorimi i hapësirës për festa komunitare, aktivitete tregtare ditore si tregje, panaire, etj. Lejohet mobilimi me pajisje urbane si kënde lojrash, stola, tavolina, ndriçim. Lejohet ndërtimi i shtigjeve për çiklistë, këmbësorë dhe të shërbimit.

- Funksione të lejuara:
  - rigjelbërim dhe kujdesje për gjelbërimin egzistues;
  - ambiente lojrash për fëmijë;
  - aktivitet tregtare - ambulant;
  - ambiente sportive, rekreative;
  - pajisje parku dhe urbane;
  - shtigje këmbësorësh.
  - shtigje ciklistike;
- Funksione të kushtëzuara:
  - struktura efimere (të përkohshme) me një kohëzgjatje të përcaktuar;
  - shtrirje e rrjeteve inxhinjerike nëntokësore dhe mbitokësore;
- Funksione të ndaluara:
  - aktivitete/objekte që nuk janë në funksion të komunitetit dhe përveç atyre të përcaktuara më siper;

**d) *Hapësirë prodhuese urbane;***

Janë ato sipërfaqe të lira brenda territorit urban të cilat përdoren për aktivitet rural të lidhur me bujqësinë, blektorinë dhe prodhimin e produkteve ushqimore tradicionale. Indeksi i shfrytëzimit për ndërtim të parcelës në këtë rast është ISHP= 10% dhe ISD= 0,8. Lejohet vendosja e objekteve të banimit të fermerëve si dhe objekte shërbimi. Lejohet përdorimi i truallit për aktivitete agroturistike duke përfshirë hotelieri, ambiente të përgatitjes së ushqimit dhe tregtimit të tij.

- Funksione të lejuara:
  - bujqësi;
  - blektori;
  - pemëtar;
- Funksione të kushtëzuara:
  - banim;
  - agroturizëm;
  - njësi tregtare private;
  - rritje e kafshëve;
  - garazhe të integruara në objekt;
- Funksione të ndaluara:
  - punishte përpunimi masiv;
  - oficina automjetesh;
  - aktivitete prodhuese ndotëse;
  - objekte tregtie me shumicë;
  - supermarketet;
  - pista sportive-motorristike;

### e) **Zonë me vlera kulturore ( nën mbrojtje);**

Përfshihen zonat e seleksionuara grafikisht në plan, të cilat duke ju referuar përmbajtjes së tyre kulturore historike përbëjnë rëndësi për trashëgiminë e komunitetit pavarësisht pronësisë së tyre private apo publike. Këto zona të cilat pas miratimit të planit shpallen nga Kuvendi Komunal me vendim të veqantë "zona nën mbrojtje", lejojnë vetëm operacione mirëmbajtjeje dhe zhvillime që nuk alterojnë karakterin e tyre. Ndërtimi në këto zona bëhet vetëm nëpërmjet projekteve urbanistike pjesore që studiojnë zonën në tërësi me qëllim ruajtjen dhe mos alterimin e vlerave. Këto zona përmbajnë objekte të arkitekturës tradicionale si kulla guri, mullinjtë tradicional, shtëpi guri, pozllome, mure rrethuese, porta hyrëse dhe të gjitha elementet arkitektonike të cilat janë të inventarizuara. Në kuadër të këtyre zonave përbahen edhe objektet e kultit dhe të kulturës fetare lokale si xhami, kisha, tyrbe, teqe të të gjitha besimeve fetare. Ndërhyrjet e lejuara për arranzhimin e territorit të "zona nën mbrojtje" janë: konservim, sanim, risanim, restaurim, rehabilitim, revitalizim, rikonstruksion, rindërtim.

Për çfarëdo ndërhyrje fizike dhe funksionale duke përfshirë vënien në funksionim dhe konvertimin e funksioneve sipas atyre të parashikuara, sipas rastit duhet marrë leje ndërtimi dhe leje shfrytëzimi pranë Komunës me aprovim final nga Instituti për Mbrojtjen e Monumenteve (rajonal ose lokal).

- **Funksione të lejuara:**

- banim;
- qendra rimore
- qerdhe dhe kopsht
- shkolla artizanati
- qendra sociale
- objekte për turizmin;
- info point kulturor;
- objekte kulturore;
- njësi të vogla administrative;

- **Funksione të ndaluara:**

- punishte përpunimi të çdo lloji;
- oficina automjetesh;
- aktivitete prodhuese;
- tregti me shumicë;
- përdorime që cenojnë integritetin e zonës.

- **Funksione të kushtëzuara:**

- banim;
- hoteleri;
- agroturizëm;
- shërbime restorimi të lidhura me objektin kryesor;

**f) Fashë afarizmi me dendësi të lartë;**

Janë ato rripa të vazhdueshëm parcelash përgjatë rrugëve, brenda vijës rregullative të cilat përdoren për aktivitet tregtar dhe afarizëm. Indeksi i shfrytëzimit të parcelës brenda kontureve të fashës mund të jetë deri ISHP= 60% duke respektuar rregullat e veçanta për njësitë ku bënë pjesë. Tipologjitet ndërtimore të lejuara janë "objekte në rradhë" dhe " objekte në rrjesht". Në kuotën 0.00 , lejohen përdorime për njësi tregtare me pakicë, shërbime, punishte të vogla artizanati, zyra dhe aktivitete terciare. Kuota e mësipërme mund të përdoret si për tregti ashtu edhe për banim.

• **Funksione të lejuara:**

- tregti me pakicë;
- prodhim dhe tregtim ushqimi me pakicë;
- punishte artizanati dhe tregtim i produkteve;
- shërbime private dhe publike;
- aktivitete terciare.

• **Funksione të kushtëzuara:**

- punishte apo veprimtari që shkaktojnë ndotje sonore (zhurmë);
- supermarketet;

• **Funksione të ndaluara:**

- punishte përpunimi masiv;
- oficina automjetesh;
- aktivitete prodhuese masive;
- tregti me shumicë;
- stacione e pompassh të karburantit;
- garazhë të inkorporuara në objekt;
- punishte apo veprimtari që shkaktojnë ndotje ambientale.

**g) Fashë afarizmi me dendësi të ulët;**

Janë ato rripa të vazhdueshëm parcelash përgjatë rrugëve, brenda vijës rregullative të cilat përdoren për aktivitete tregtare/ afarizmi. Indeksi i shfrytëzimit të parceles është deri ISHP= 35% dhe ISD= 0.8 duke respektuar rregullat e veçanta për njësitë ku bën pjesë. Në kuotën 0.00 ,lejohen përdorime për njësi tregtare, përpunim ushqimi dhe shërbime restorimi, punishte të vogla prodhimi, magazina.

• **Funksione të lejuara:**

- tregti me pakicë/shumicë;
- ekspozita;
- banim;
- hoteleri;
- prodhim dhe tregtim ushqimi;

- punishte të vogla prodhimi;

- magazinim;

- **Funksione të kushtëzuara:**

- agroturizëm;

- oficina automjetesh;

- **Funksione të ndaluara:**

- punishte përpunimi masiv;

- aktivitete prodhuese masive;

- punishte apo veprimitari që shkaktojnë ndotje sonore (zhurmë);

- stacione të pompave të karburantit;

- punishte apo veprimitari që shkaktojne ndotje ambientale;

**h) *Sipërfaqe transporti;***

Janë ato sipërfaqe të destinuara kryesisht për koridoret e transportit, për vendosjen e objekteve të sistemit të shërbimit të transportit urban dhe interurban. Gjithashtu këto sipërfaqe janë destinuar edhe për trotuare, pasazhe ciklistike, sipërfaqe parkimi për stacionet e pompimit të karburantit, stacionin e autobusave. Mund të përdoren edhe për aktivitete të tjera që lidhen me funksionin kryesor si njësi tregtare me pakicë apo shërbime restorimi.

- **Funksione të lejuara:**

- koridore transporti, lëvizje bashkë me pajisjet;

- stacione urbane dhe interurbane;

- parking automjetesh;

- **Funksione të kushtëzuara:**

- stacione e pompave të karburantit;

- oficina;

- njësi tregtare;

- shërbime restorimi (restorante).

- **Funksione të ndaluara:**

- ndalohet ndërtimi i çdo objekti përveç atyre me funksionet e sipërpërmendura

## IX. RREGULLAT PËR KUALIFIKIMIN HAPËSINOR

### 9.1 Rregullorja e përgjithshme

Regullorja e përgjithshme përmban rregulla që përfshinë të gjithë territorin urban duke e konsideruar atë si një tërësi.

Rregullorja për kualifikimin hapësinor aplikohet sa herë që brenda territorit të PRrU - Qendër Junik shprehet interes i për:

- realizimin e një ndërtim të ri ;
- rikonstrukcionin apo përfundimin e një ndërtese egzistuese ;
- rekonstrukcionin me ndryshim të planimetrisë së objektit;
- shtesa të objekteve ekzistuese;
- prishje të një ndërtimi

Për secilën nga këto kategori, i interesuari duhet të pajiset me leje në Komunë, pranë Drejtoratit të Urbanistikës.

Ndryshimet e funksionit duhet t'i referohen gjithmonë funksioneve bazë të sipërfaqeve, të cilat janë të diferencuara në pjesën grafike me mapatura dhe ngjyra të ndryshme.

## X. TIPOLOGJITË NDËRTIMORE

### 10.1 Përshkrim i përgjithshëm

Ky plan rregullues bënë pjesë në klasën e planeve që bazojnë përshkrimet dhe kufizimet në formë, (form based plan). Tipologjitet ndërtimore karakterizojnë përsa i përket karakteristikave fizike por jo vetëm, njësinë elementare përbërëse të ambientit urban që është objekti si dhe hapësira që kufizohet prej tij. Tipologjia përmban të dhënat mbi gabaritet e objektit, sipërfaqet minimale dhe maksimale të parcelës ndërtimore, modulin e aggregimit, karakteristikat arkitekturore, karakteristikat funksionale. Duke e konsideruar objektin si një organizëm dhe njëkohësisht pjesë të një organizmi më të madh, kushtëzimet dhe mundësitë që ai jep janë pjesë e rëndësishme e egzistencës së tij dhe të ambientit urban në tërësi.

Në Junik duke ju referuar analizave të morfolojisë urbane janë evidentuar 5 tipologji objektesh dhe parcelash, egzistuese dhe në fazë zhvillimi. Këto tipologji janë rimarrë dhe përpunuar nga ky plan, duke përbërë bazën për fragmentimin dhe organizimin e territorit urban brenda PRrU-Qendra Junik. Tipologjitet ndërtimore ndahen në a- *Tipologji Ndërtimore Bazë* ku hyjnë objektet për banim dhe funksione që lidhen me ato dhe b- *Tipologji Ndërtimore Speciale* ku futen objektet e rëndësise së veçantë dhe me influencë në shkallë kolektiviteti.

Për çdo tipologji jepen përcaktime të detajuara, përsa i përket parcelës, funksioneve, gabaritit të objektit, mbulesës, fasadës, materialeve të fasadës, ngjyrave, dekoracioneve si dhe restrikzionet eventuale.

## 10.2 Tipologji ndërtimore bazë

a) Objekte në radhë, janë objekte që rradhiten përgjatë aksit të rrugës duke u bashkangjitur me njëri-tjetrin në faqet perpendikulare me të. Si tipologji zhvillohet si pasojë e vlerës që ka fronti nga rruga dhe ekonomicitetit që ka ndërtimi. Zakonisht pozicionohen në akset tregtare, aty ku çmimi i tokës është edhe më i lartë. Këto objekte tregojnë nga rruga faqen më të ngushtë dhe lidhen me rrugën me anë të katit përdhesë që zakonisht funksionon si biznes. Sistemi konstruktiv mund të jetë me mure të vazhduara ose skelet betonarme. Ndërprerja e vargu të objekteve bëhet çdo 20-35m.




Fig. 18 Objektet në radhë, Viterbo, Itali / burimi: internet

PARCELA	Parcela min. e ndërtueshme: 250m <sup>2</sup> Parcela max. e ndërtueshme: 500m <sup>2</sup> Gjerësia e frontit nga rruga: 5 - 7m <sup>2</sup>	MATERIALET E FASADËS	-Suvatim dhe lyerje; -Gur i vendit aplikuar si veshje; -Dru i llakuar për elemente; -Metal i punuar për elemente;
GABARITET E OBJEKTIT	<ul style="list-style-type: none"> <li>Etazhiteti: P+2</li> <li>Lartësia max: 10.5 m</li> <li>Lartësia max e kuotës 0.00: + 0,60</li> <li>Gjerësia e frontit nga rruga: 5-7m</li> <li>Thellësia max: 14m</li> <li>Sip. e hapjeve në fasade: 30 - 40%</li> </ul>	NGJYRA E FASADËS	Ngjyra me bazë natyrore jo të ndezura
FUNKSIONI	Kuota përdhe: afarizëm, shërbime Kuota e parë: banim Kuota e dytë: banim	DEKORACIONI	<ul style="list-style-type: none"> <li>Kornizime të lehta të çarjeve</li> <li>Veshje xokoli deri në lartësinë 1m</li> <li>Dru për strehën e çatisë dhe per elemente</li> <li>Metale të punuar për elemente.</li> </ul>
MBULESA	<ul style="list-style-type: none"> <li>Çati dy ujëse me kulm paralel me aksin e rrugës;</li> <li>Tjegulla konike me argjile të kuqe</li> <li>Streha mund të dale max 1m nga vija ndërtimit</li> </ul>	RESTRIKSIONE	Ndalohet nxjerra e ballkoneve apo e çdo tipi konsole nga rruga.

*b) Objekti në linjë*, është një tipologji për banim që zhvillohet me seksione paralele me aksin e rrugës. Zakonisht përdoret për rezidencia në brendësi të lagjeve të banimit. Objekti ka hyrje direkte nga kopshti me të cilin ndahet nga rruga dhe ka një komunikim të mirë me oborrin nga ana e pasme. Me anë të kësaj tipologjie kryhet një dendësim optimal i truallit duke e shfrytëzuar më së mirë atë si dhe ruan karakteristikat e komoditet dhe të privatitetit. Këto objekte tregojnë nga rruga faqen më të gjërë duke mbajtur një thellësi të reduktuar. Sistemi konstruktiv mund të jetë me mure të vazhduara ose skelet betonarmeje. Ndërprerja e vargut të objekteve bëhet çdo 24- 36m.



Fig. 19 Objektet në linjë, / burimi: METRO-Polis

PARCELA	Parcela min. e ndërtueshme: 300m <sup>2</sup> Parcela max. e ndërtueshme: 700m <sup>2</sup> Gjerësia e frontit nga rruga: 6 - 12m <sup>2</sup>	MATERIALET E FASADËS	-Suvatim dhe lyerje; -Gur i vendit aplikuar si veshje, në xokola apo pjesë të tjera të objektit; -Dru i llakuar për elemente çati dritare, etj.; -Metal i punuar për elemente;
GABARITET E OBJEKSTIT	<ul style="list-style-type: none"> <li>Etazhiteti: B+ P+1+NK/ B+P+2</li> <li>Lartësia max: 12.5 m</li> <li>Lartësia max e kuotës 0.00: + 1,20</li> <li>Gjerësia e frontit nga rruga: 6-12m</li> <li>Thellësia max: 13m</li> <li>Sip. e hapjeve ne fasade: 20 - 30%</li> </ul>	NGJYRA E FASADËS	Ngjyra me bazë natyrore jo të ndezura
FUNKSIONI	Kuota përdhe: banim / biznes Kuotat e bodrumit: garazh, magazinim Kuotat e tjera: banim	DEKORACIONI	<ul style="list-style-type: none"> <li>Kornizime të lehta të çarjeve</li> <li>Veshje xokoli deri në lartësinë 1m</li> <li>Dru për strehën e çatisë dhe për elemente</li> <li>Metale të punuar për elemente.</li> </ul>
MBULESA	<ul style="list-style-type: none"> <li>Çati dy ujëse me kulm paralel me aksin e rrugës;</li> <li>Tjegulla konike me argjile të kuqe</li> <li>Streha mund të dale max 1.20m nga vija ndërtimit</li> </ul>	RESTRIKSIONE	Ndalohet nxjerra e ballkoneve apo e cdo tipi konsole më tepër se 1.20 nga vija e ndërtimit dhe në çdo rast mbi katin përdhes.

c) Objekte "perde urbane" - kjo tipologji është përdorur për kualifikimin e akseve dhe shitetoreve identifikuuese të qendrës urbane. Objektet vendosen me fasada në vijën rregulluese duke krijuar vazhdimësi lineare të pandërprerë. Homogeniteti i fasadave dhe vazhdimësia janë karakteristika thelbësore për krijimin e hapësirave urbane me identitet dhe karakter. Gjithashtu për të siguruar vazhdimësinë duhet pasur kujdes në ruajtjen e parametrave për lartësitë e kateve, tipin e çarjeve, ritmin e çarjeve, xokolaturat, qemeret e çative. Kjo tipologji shfrytëzon maksimalisht vijën e rrugës dhe përqëndrohet kryesisht në akse tregtare, sheshe apo tregje. Kati përdhes nuk duhet të shkëputet nga trualli dhe kuota e trotuarit më tepër se pak këmbë shkalle. Këto objekte tregojnë nga rruga faqen më të gjerë duke mbajtur një thellësi të reduktuar, por mund të ketë dhe raste kur objekti zhvillohet në thellësi. Sistemi konstruktiv mund të jetë me mure të vazduara ose skelet betonarmeje. Ndërprerja e vargut të objekteve bëhet çdo 30-50m.





Fig. 20 Objektet "perde urbane", Salzburg , Firenze,/ foto Eled Fagu

PARCELA	Parcela min. e ndërtueshme: 150m <sup>2</sup> Parcela max. e ndërtueshme: 400m <sup>2</sup> Gjerësia e frontit nga rruga: 4 - 12m <sup>2</sup>	MATERIALET E FASADËS	-Suvatim dhe lyerje; -Gur i vendit aplikuar si veshje, në xokola apo pjesë të tjera të objektit; -Dru i llakuar për elemente çati dritare, etj.; -Metal i punuar për elemente;
GABARITET E OBJEKSTIT	<ul style="list-style-type: none"> <li>Etazhiteti: P+2 / P+1+NK</li> <li>Lartësia max: 10.5 m</li> <li>Lartësia max e kuotës 0.00: + 0,20</li> <li>Gjerësia e frontit nga rruga: 4-12m</li> <li>Thellësia max: 13 m</li> <li>Sip. e hapjeve në fasadë: kati përdhe 60 - 80%; katet e sipërme 30-50%</li> </ul>	NGJYRA E FASADËS	Ngjyra me bazë natyrore jo të ndezura
FUNKSIONI	Kuota përdhese: biznes, artizanat Kuotat e tjera: biznes, zyra, banim	DEKORACIONI	<ul style="list-style-type: none"> <li>Kornizime të lehta të çarjeve</li> <li>Veshje xokoli deri në lartësinë 1m</li> <li>Dru për strehën e çatisë dhe per elemente</li> <li>Metale të punuar për elemente.</li> </ul>
MBULESA	<ul style="list-style-type: none"> <li>Çati dy ujëse me kulm paralel me aksin e rrugës;</li> <li>Tjegulla konike me argjile të kuqe</li> <li>Streha mund të dale max 1 m nga vija e ndërtimit</li> </ul>	RESTRIKSIONE	-Ndalohet nxjerra e ballkoneve apo e çdo tipi konsole nga vija e ndërtimit.

*d) Objekte te veçuara, vilë -* është tipologjia më e përhapur. Siguron komoditet dhe privatitet maksimal. Objektet vendosen të tërhequra prej rrugës me oborr në të katër anët. Për vetë vendosjen e shkëputur nga objektet e tjera kjo tipologji kërkon sipërfaqe më të madhe parcele dhe është e preferueshme për zona të distancuara prej qendrës.



Burimi: Internet

Fig. 21 Objektet të veçuara, vilë, Kulla e Mazrekajve/ foto Eled Fagu

PARCELA	Parcela min. e ndërtueshme: 500 m <sup>2</sup> Parcela max. e ndërtueshme: 1000 m <sup>2</sup> Gjerësia e frontit nga rruga: 15- 30 m <sup>2</sup> Thellësia: max 35 m <sup>2</sup>	MATERIALET E FASADËS	-Suvatim dhe lyerje; -Gur i vendit aplikuar si veshje, në xokola apo pjesë të tjera të objektit; -Dru i llakuar për elemente çati dritare, kapake etj.; -Metal i punuar për elemente;
GABARITET E OBJEKSTIT	<ul style="list-style-type: none"> <li>Etazhiteti: B+P+2 / B+P+1+NK</li> <li>Lartësia max: 12.5 m</li> <li>Lartësia max e kuotës 0.00: + 1,20</li> <li>Sip. e hapjeve në fasadë: 20-40%</li> </ul>	NGJYRA E FASADËS	Ngjyra me bazë natyrore jo të ndezura
FUNKSIONI	Kuota përdhese: banim, ekonomi familiare	DEKORACIONI	<ul style="list-style-type: none"> <li>Kornizime të lehta të çarjeve</li> <li>Veshje xokoli deri në lartësinë 1.2m</li> <li>Dru natyral për strehën e çatisë dhe per elemente</li> <li>Metale të punuar për elemente.</li> </ul>
MBULESA	<ul style="list-style-type: none"> <li>Çati disa ujëse</li> <li>Tjegulla konike me argjile të kuqe</li> <li>Streha mund të dale max 1.2 m nga vija ndërtimit</li> </ul>	RESTRIKSIONE	

### 10.3 Tipologji ndërtimore speciale

Kjo tipologji përfshin të gjitha objektet strategjike me influencë në të gjithë komunitetin. Objektet speciale ndërtohen në parcela publike. Programi funksional mund të jetë i shumëlojshëm dhe përcaktohet me dëtyrë specifike projektimi. Mund të përbajnë shërbime, funksione administrative, kulturore, edukative, fetare, etj.. Në rast nevoje, objektet speciale mund të ndërtohen edhe në bashkëpunim me investitorë privat.

Objektet publike janë pjesë e rëndësishme e memories kolektive dhe për këtë arësy duhet të përbajnë cilësi të lartë ndërtimore dhe jetëgjatësi. Arkitektura e objekteve publike duhet të respektojë ndjeshmërinë estetike vendase dhe të harmonizojë me trashëgiminë ndërtimore ekzistuese.



Fig. 22 Objekte speciale,Bajram Curri / burimi: Internet

GABARITET E OBJEKTIT	<ul style="list-style-type: none"><li>Etazhiteti: max B+P+2</li><li>Lartësia max: 13 m</li><li>Lartësia e kuotës 0.00: + 0,20</li><li>Sip. e hapjeve në fasadë: 30-60%</li></ul>	MATERIALET E FASADËS	<ul style="list-style-type: none"><li>-Suvatim dhe lyerje;</li><li>-Gur i vendit aplikuar si veshje;</li><li>-Dru i llakuar për elemente cati dritare, kapakë etj.;</li><li>-Metal i punuar për elemente;</li></ul>
DEKORACIONI	<ul style="list-style-type: none"><li>Kornizime të çarjeve</li><li>Dru natyral për strehën e çatisë dhe për elemente</li><li>Metale të punuar për elemente.</li></ul>	RESTRIKSIONE	<ul style="list-style-type: none"><li>-Fasada me xama të ngjyrosur;</li><li>-Veshje me materiale të huaja përvendin;</li><li>-Ngjyra të ndezuara.</li></ul>

## XI. RREGULLIMI I PARCELAVE NDËRTIMORE

Rregullimi i parcelave bazohet në keta tregues themelorë urbanistik:

### 11.1 ISHP – Indeksi i shfrytëzimit të parcelës

*Indeksi i shfrytëzimit të parcelës* është raporti i sipërfaqes së lejuar për ndërtim të shputës së objektit kunddrejt sipërfaqes së parcelës që përfshihet brenda vijes rregulluese. Indeksi i shfrytëzimit të parceles shprehet në formë maksimale. Ky indeks për parcelat që prek plani, përcaktohet i veçantë për çdo nën-njësi, fillon nga 5 % për sipërfaqet e gjelbërta dhe shkon deri në 70 % për sipërfaqet publike. Për zonat e banimit sipas karakterizimit të dendësisë, së ulët apo mesatarja është 35% dhe 45%.

### 11.2 N.kt – Numri i kateve

përcakton numrin e kateve të banueshme, të ndërtuara mbi dhe nën tokë. Me P-nënkuptohet kati perdhes, me B- nënkuptohet bodrumi ose kati nën tokë, me 1 ose 2kt - nënkuptohet numri i kateve të sipërme. Pra, B+P+1kt nënkupton, bodrum+përdhesë+1 kat.

Numri maksimal i kateve për territorin e qendrës është B+P+2kt. Të dhëna më specifike jepen për çdo njësi në mënyrë të veçantë.

Mansarda llogaritet kat në rast se  $\frac{1}{3}$  e sipërfaqes kanë lartësinë e një kati banimi. Bodrumi llogaritet si kat i plotë në rast se del mbi nivelin e rrugës më shumë se 1.2m.

### 11.3 VR- Vijë rregulluese

Vija rregulluese tregon vijën e ndarjes së parcelës për interes të përbashkët dhe për interes të veçantë brenda njësisë. Vija rregulluese siguron njëkohësisht funksionimin normal të aktiviteteve në hapësirat me interes të përbashkët (komunikacionit) si edhe mbron interesin e veçantë.

Vija rregulluese siguron korridorin për vendosjen e rrjetit të infrastrukturës, në koridorin ndërmjet saj dhe vijës së rrugës, si ujësjellësit, rrjetit elektrik, kanalizimit, telefonisë, etj. Pozicionimi dhe dimensionimi i vijave rregulluese në lidhje me aksin rrugorë është përcaktuar grafikisht në planin e infrastrukturës rrugore dhe në profilet rrugore.

#### Rregullat e përcaktimit të vijës rregullative

- Vijat rregulluese dhe boshti i komunikacionit përbëjnë bazat e elementeve për përcaktimin e rrjetit të komunikacionit;
- Vija rregulluese konsiderohet si horizontale, vertikale, mbitokësore dhe nëntokësore;
- Nuk lejohet asnjë lloj ndërtimi në koridorin ndërmjet vijave rregulluese, qoftë edhe me konsola me bazë jashtë këtij koridori;

- Gjërësia e koridorit mes vijave rregulluese është përcaktuar varësisht nga funksioni dhe rangu i rrugës, në këtë plan janë përdorur këto gjerësi vijash rregulluese:
  1. për rrugët regionale, radiale të qendrës 10.90 m;
  2. për rrugët regionale, unazore të qendrës 10.00 m;
  3. për rrugët regionale, radiale të qendrës 8.00 m;
  4. për rrugët e brendshme të lagjeve të banimit 6.00 m ;
  5. për rrugët e brendshme të sipërfaqeve të banimit 4.50m .

#### **11.4 VN- Vijë ndërtimore**

Vija ndërtimore përcaktohet me distancë metrike në raport me vijën rregulluese. Çdo ndërtim i ri apo rindërtim duhet të pozicionohet me fasadë në vijën ndërtimore duke u shtrirë përbrenda hapësirës së kufizuar prej saj. Vija ndërtimore mund të përputhet me vijën rregulluese ose mund të jetë në largësi të përcaktuar. Në pjesën grafike të planit janë përcaktuar vijat ndërtimore për çdo nënnjësi veçanërisht.

#### **Regullat e përcaktimit të vijës ndërtimore**

- vijat ndërtimore përcaktojnë vijueshmërinë dhe homogenitetin e koridoreve të transportit ;
- vija ndërtimore konsiderohet si mbitokësore;
- vija ndërtimore mund të superohet vetëm me konsola sipas tipologjive të ndryshme ndërtimore dhe në çdo rast jo më shumë se 1.20 m;
- gjërësia e koridorit mes vijave rregulluese dhe vijave ndërtimore është përcaktuar në varësi të rangut të rrugës, gjerësisë se përgjithshme të hapësirës së koridorit, karakterit të banimit, situatës ekzistuese.

#### **11.5 Distancat minimale ndërmjet objekteve**

Dy objekte mund të qëndrojnë ngjitur me njëri tjetrin duke parashikuar vetëm fugën antisizmike.

Për objektet e shkëputura nga njeri-tjetri distanca minimale midis tyre është 4 m, duke mos llogaritur strehën e çatisë.

Për fasadën me çarje (dritare) distanca minimale nga kufiri i pronës llogaritet me këtë formulë:

$$2m + 1 * N. e kateve të shprehur në metra$$

Psh. Lartësia e objektit  $B+P+2kt = 2+1*2 = 4m$  largim nga kufiri i pronës

## 11.6 Kushtet e parcelimit dhe riparcelimit

Parcela minimale ku mund të ndërtohet brenda kufirit të mbulimit të këtij plani është 150 m<sup>2</sup>. Parcela maksimale për objekte me tipologji bazë është 1000 m. Riparcelimi bëhet duke ju referuar tipologjive ndërtimore me shifra mbi parcelën minimale dhe maksimale.

Te gjitha parcelat që janë nën sipërfaqen minimale për ndërtim duhet të bashkohen me parcelat fqinje dhe të gjejnë zgjidhje të përbashkëta për ndërtim. Parcelat të cilat me tituj pronësie kalojnë sipërfaqet maksimale për tipologjitet, duhet të paraqesin pranë komunës planin e riparcelimit të bazuar në tipologjitet ndërtimore.

## 11.7 Kushtet për ndërprerjen e vargut ndërtimorë

Vargu ndërtimorë nënkupton perde ndërtimore të vazhdueshme me distancë minimale të ndërtimeve nga njëri-tjetri, më të vogël se 2 m për secilin objekt nga kufiri i pronës, apo kompleksive 4 m.

Ndërprerje e vargut ndërtimorë nënkupton lejimin e një koridori hapësinorë midis objekteve, minimumi 4 m gjerësi.

Për brezat ndërtimorë me tipologji “perde”, që në rastin e Junikut përfshihen në fashiën e afarizmit me dendësi të lartë, është e detyrueshme shkëputja e brezit çdo 60-100 m.

Për brezat ndërtimore me tipologji në radhë është e detyrueshme shkëputja çdo 50 – 70 m.

Për brezat ndërtimore me tipologji në linjë është e detyrueshme shkëputja çdo 50 – 70 m.

## 11.8 Kushtet e hyrjes në parcelë dhe parkimi

Parkimi i automjeteve të çdo tipi lejohet vetëm në brendësi të sipërfaqeve të njësive (sipërfaqe e kufizuar nga vijat rregullative) dhe në sipërfaqet e transportit të përcaktuara nga komuna për këtë qëllim.

Në sipërfaqet private parkimi mund të bëhet mbi tokë apo nëntokë sipas tipologjive të objekteve dhe parcelave. Nëse parkimi bëhet nën tokë, rampa e zbritjes duhet të ketë pjerrësi max = 50%. Rampa e zbritjes duhet të përfshihet e gjitha brenda vijës rregulluese dhe brenda kufirit të rrrethojës.

Për parcelat që shtrihen në brezat e dytë e të tretë të ndërtimit dhe që nuk kanë qasje nga rruga, duhet të sigurojnë një koridor rrugore me minimum 4 m gjerësi që të kthehen në truall ndërtimorë. Ky kusht duhet të plotësohet për kërkesën e pajisjes me leje ndërtimi nga organet kompetente.

## 11.9 Kushtet për definimin e rrrethojave

- a) Nuk lejohet rrrethimi i objekteve publike, laike dhe fetare.
- b) Lejohet rrrethimi trasparent deri në lartësinë 1.2m, i gjelbëruar për objektet e rëndësisë së veçantë dhe të sigurisë.
- c) Lartësia maksimale e lejuar për muret që rrrethojnë parcelat/oborret private është 2,20 m. Për të gjitha tipet e rrrethojave që kalojnë këtë lartësi duhet të merren masa për uljen e tyre deri në lartësinë e lejuar.
- d) Përgjatë itinerarit turistik rrrethojat duhet të jenë realizuar me murature guri të vendit e ndërtuar sipas mënyrave tradicionale të siguruara me breza druri. Në alternativë të muratures plotë, rrrethojat mund të kryhen me brez murature deri në lartsënë 0,9 m dhe me metal të punuar apo dru në pjesën e sipërme. Muret rrrethuese duhen gjelbëruar në pjesën e sipërme me bimë kacavjerrëse, pemë frutore apo pemë dekorative.
- e) Kopshtet private që shtrihen përgjatë parkut të Erenikut duhet të përbajnjë rrrethoja të kombinuara druri dhe gurë.

## 11.10 Kushtet për renovim dhe rindërtimin e objekteve ekzistuese

Në rastet kur ndërmerren operacione renovimi, rindërtimi apo çdo lloj ndërhyrje tjeter që përkufizohet me ndërtim në mënyrë që të pajiset me leje shfrytëzimi nga komuna, ndërhyrja duhet të jetë konform kërkesave të rregullores së përgjithshme dhe rregulloreve të veçanta për njësitë.

## 11.11 Kushtet për hapësirat e lira.

Përdorimet e hapësirave të lira janë kushtëzuar nëpërmjet rregullores së përgjithshme e cila përkufizon përdorimet e mundshme të çdo hapësire brenda territorit të zonës nën studim.

- f) Hapësirat e lira nuk duhet të përdoren si vend për hedhjen e mbeturinave urbane.
- g) Të gjitha hapësirat e lira publike duhet të projektohen dhe kualifikohen në përshtatje me përdorimin.
- h) Hapësira private, e lirë ndërmjet vijës rregullative dhe vijës ndërtimore duhet të gjelbërohet dhe kualifikohet. Nuk lejohen ndërtime amorfë/temporane të çfarëdo lloji si depo, magazina etj., edhe nëse janë ndërtuar me materiale të lehta. Nuk lejohet betonimi, asfaltimi apo çdo punim që bllokoni penetrimin e ujit në tokën brenda parcelës private në më tepër se 30% të sipërfaqes së përgjithshme të saj. Gjelbërimi i lartë nuk mund të mbillet në distancë më të vogël se 1 m nga vija rregullative.

## ANEKS 1

### Intenerari Turistik

(referimi në materialin grafik)

Ky itinerar orbiton rreth qendrës duke vënë në komunikim zonat e trashigimisë të cilësuara “nën mbrojtje” nga ky plan. Për vet karakterin historik që bart kjo trajktore, duhet të prezantojë vlerat më të mira të ambientit urban. Kjo nënkupton rikualifikime në vazhdimësi përgjatë gjithë aksit përshkues. Ndërhyrjet nuk përfshijnë vetëm zonat e trashëgimisë por edhe objektet, rrethojat, shtresat apo hapësira të tjera përgjatë saj.



Firenze /Burimi: Internet


*Autoritetet komunale* duhet të ken kujdes në dhënien e lejeve për ndërtim apo për shfrytëzim përgjatë itinerarit turistik, duke u siguruar për konformitetin e ndërhyrjeve lidhur me parashikimet e këtij plani dhe vizionin e përbashkët për Junikun qytezë turistike.

*Qarkullimi* në këtë trajktore do të jetë kryesisht këmbësorik dhe unisens (një drejtim) për automjetet. Vet shtrimi i ashpër me gurë do të rezultojë i dobishëm në ngadalësimin e shpejtësisë së automjeteve duke e bërë këtë trajktore më të përshtatshme për këmbësorë apo çiklistë. Ky konceptim i shtresave dhe detajeve përkatëse do të risjellë në Junik skena nga e kaluara jo e largët dhe do të rinisë ndjenjën e përkatësisë tek banorët.

Nuk parashikohen trotuare, por një shtrat i vazhdueshëm rruge i punuar me gurë të vendit. Largimi i ujit në rrugë mendohet të bëhet me një kanalizim në mes të rrugës. Nuk lejohet përdorimi i kapakëve të pusetave prej betoni, lejohen vetëm kapakë pusetash prej gize.




Berati/ foto Sotir Dhamo






Burimi/ Internet

*Pajisjet e Itinerarit Turistik* kanë rëndësi përsa i përket përdorimit dhe influencojnë në karakterin dhe vazhdimësinë e imazhit. Ky koridor konsiderohet si një “gjerdan” vendesh të larmishme përgjatë vazhdimësisë së tij. Si i tillë ai duhet të përmbajë një seri ngjarjesh të përkthyera në formë urbane, si sheshe të vogla të shtruara e të gjelbëruara të vendosura në mënyrë alternative. Ndërthurjet me vijat e ujit, jazet i shtojnë këtij koridori freski dhe zhurmën e këndshme të ujit të rrjedhshëm. Në disa vende këto jaze edhe mund të zgjerohen për të krijuar mini basene të cilat bëhen dhe pika takimi. Pajisja e këtyre poleve përgjatë trajktoreve turistike duhet të jetë shumë i dukshëm dhe pasqyrë e vendit ku ndodhen duke ruajtur dhe theksuar karakterin ekzistues.



Berati/ foto Sotir Dhamo



Burimi: Internet

*Ulëse me bazament guri dhe ndenjëse prej druri të punuara lehtë gjithashtu kontribuojnë në shtimin e karakterit mesjetar të itinerarit. Ato mund të stolisin mini-sheshet por mund të vendosen me shumë efektivitet edhe përgjatë koridoreve pranë dyerve të drunjëta. Nuk duhet egzagjeruar me tipe ndenjësesh me dizajn të ndryshëm pasi rrezikohet humbja e vazhdimesisë së itinerarit. Ndriçimi është përsëri një element thelbësorë që pajisë dhe kualifikon hapësirën. Itinerari turistik duhet të përçojë siguri dhe intimitet tek kalimtarët.*





Burimi: Internet

*Ndriçimi* mund të bëhet me llampadarë që rimarrin kandilet historik me hekur të farkëtuar, mund të fiksohen në shtylla apo në formë L në muret e gurta. Gjithashtu ndriçime specifike mund të aplikohen për theksimin e ngjarjeve të ndryshme përgjatë itinerarit siç mund të jenë sheshet, elemente me domethënie historike, gjelbërimi, etj. Këshillohet ndriçim që anon nga gama (toni i ndriçimit) e nxeh të.



Burimi: Internet

*Informimi, orientimi, shenjëzimi* janë përsëri elemente të domosdoshëm të itinerarit turistik. Pas katalogimit të vlerave historike, pranë objekteve me vlerë duhet të vendosen tabela dy gjuhëshe që përshkruajnë historinë dhe të dhëna mbi objektin. Përgjatë aksit turistik vizituesit duhet të informohen dhe drejtohen drejt eveneve të ndryshme nëpërmjet sinjalistikës. Sinjalistika duhet të përbajë elemetet komunikativ sipas simbolikës ndërkontaktore dhe njëkohësishtë duhet të kërkojë të veçantën e dizajnit që lidhet me vendin.



Burimi: Internet

## ANEKS 2

### Tregu ("Çarshia e re") i Junikut

(referimi në materialin grafik)

*Tregu (pazari) si institucion urban, karakteristik e qendrave evropiane ka përcaktuar në histori bazat dhe strukturat për jetën ekonomike qytetare. Ky institucion është një nga komponentet më dinamik të qytetit, pa të cilin nuk do të ishte e mundur rritja në dimension, rëndësi dhe prodhimtari. Një vend ku pricipet më të pastra demokratike, të ekonomisë së tregut bëjnë të mundur shtimin e mirëqenies jo vetëm fizike por edhe shpirtërore e sociale.*




Mercato S.Ambroggio, Firenze: Internet

Artizanati në qytetet e vjetra shqipëtare historikisht ka qenë i lidhur me tregtinë me shkëmbimin dhe komunikimin e kulturave që në mënyrë të pa evitueshme kanë sjellë zhvillim dhe përparim. Tregu (pazari) i Tiranës që sot ka ndërruar shkallë, po ashtu si në qytete të tjera – Gjakova apo Çarshia e Pejës përvèc tregtimit të prodhimeve rurale apo qytetare zhvilloi edhe një karakteristikë tjetër fundamentale që e ktheu tregun në një shkollë artizanati me plot kuptimin e fjalës, që tashmë nuk zhvillohej nëpër oborre private por në qzell të hapur në komunikim të drejtpërdrejtë me publikun. Punishte të vogla të trashëguara familjarisht prodhonin dhe tregonin artin e tyre. Në këtë mënyrë është zhvilluar identiteti i familjeve, zanatçinjëve që me prodhimet e tyre kanë kontribuar në rritjen e influencës dhe emrit të qyteteve. Eshtë një koncept tërësisht i kundërt me supermarketin dhe prodhimin internacional, bëhet fjalë për një shpërndarje dhe jo koncentrim të aktivitetit ekonomik.



Fig. 23 Shtrirja e Tregut (Pazarit) të Junikut - Pjesë nga Harta e Destinimit të Sipërfaqeve, PRrU-Junik

Me rritjen e popullsisë dhe mundësive të lëvizjes Junikut i bëhet i nevojshëm një vend tregtie permanente ( i qëndrueshëm). Pozicionimi i tregut (pazarit) të Junikut, në një koridor që vë në komunikacion viset shqipëtrare, është i natyrshëm dhe i volitshëm. Përmirësimet në transport e bëjnë edhe më të thjeshtë zhvillimin e veprimitarisë tregëtare. Sot në Junik ka një treg me prodhime bujqësore që zhvillohet në qill të hapur me frekuencë javore. Gjithashtu ekzistojnë një seri dyqanesh përgjatë rrugës Deçan-Batushë të cilat janë fragmentare dhe nuk jepin zgjidhje të vazhdueshme, por tregojnë shenja zhvillimi të cilat duhen marrë parashysh dhe promovuar. Përsa i përket nivelit të shërbimeve duket i nevojshëm shtimi dhe përmirësimi i tyre.



Pazari i Krujës: Internet



Ponte Vecchio, Firenze: Internet

**1. *Imazhi urban.*** Shumë shpesh në memorien kolektive, qendra përfaqeson fytyrën e qytetit. Rrugët e gurta me vitrinat e vazhduara të ndriçuara nga toni i verdhë karakteristik, nuk mund të mos sjellin në mendje qendrën historike të Firencës. Po ashtu kaldrëmi karakteristik dhe çatitë e drunjta që të kalojnë mbi kokë, sjell referanca të qarta nga tregu (pazari) i Krujës. Imazhi i qytetit që ushqen memorien kolektive lidhet me stabilitetin, vazhdimësinë dhe kulturën kolektive për të cilat duhet investuar. Është ky imazh që duket se ende nuk është konsoliduar në qendrën e Junikut megjithëse egzistojnë shenjat të dukshme përmirësimesh. Për këtë arsy, pikërisht bëhet fjalë për shenja që tregojnë fillime, është tepër e rëndesishme në këtë fazë të sankzionohen dhe rregullohen ndërhyrjet urbane në këtë pjesë të favorshme për ndërtimet e reja por po për këtë arsy dhe e rrezikuar të humbas identitetin dhe përfaqesinë si ftyra e qytezës.



**2.** *Perdet ndertimore apo tasadat e objekteve qe perimetrojnë koridorin luajnë një rol të rëndësishëm në formimin e karakterit hapësiror i cili reduktohet deri në shkallë elementesh. Ndërhyrjet e parashikuara në këtë koridor nëpërmjet tipologjisë "perde", i përkasin si ndërtimeve të reja po ashtu edhe rikonstrukzionit të ndërtimeve egzistuese.*

Detyrë e komunës së Junikut është të përpiloj një projekt të përgjithshëm rikonstrukzioni i cili do të përfshij studimin e gjithë koridorit, duke ju referuar parametrave tipologjik të përcaktuar nga plani. Ndërhyrja mund të konsiderohet si një bashkëveprim i komunës me pronarët e objekteve të cilët brenda një afati të përcaktua, duhet të ndërmarrin operacione rikualifikimi të kushtëzuara nga projekti.

**3.** *Funksionet.* Faktor thelbësor në funksionimin e një qendre me funksione tregtare dhe shërbime është vazhdimësia dhe përqëndrimi i aktiviteteve. Përcaktimi tipologjik i objekteve të pozicionuara në këtë fashë përmban referenca të qarta për funksione biznesi në katet përdhes dhe afrimin e objekteve në vijë të parë lidhur me rrugën. Njësi tregtare në detaj apo me pakicë, laboratore të vogla artizanati, restorante, kafene apo ambiente dëfimi mund të jenë klasa funksionesh të pranueshme dhe që kontribuojnë në karakterin e tregut (pazarit) si aks me përqëndrim aktivitetesh. Funksionet administrative dhe të kultit që sot përmban qendra dhe që do të shtohen në të ardhmen, krijojnë organizma që funksionojnë shumë mirë me aktivitetet private. Vija e dytë e ndërtimeve mund të shfrytezohet si për banim ashtu edhe për magazina të vogla në funksion të tregut. Lejet e shfrytezimit janë një procedurë burokratike që duhet të rregullojë funksionimin e tregut duke i dhënë atij karakterin e duhur funksional. Në këtë logjikë duhen promovuar iniciativat private që përbajnë origjinalitet sikurse duhen shtyrë të përzgjedhin lokacione të tjera njësitë tregtare me shumicë, supermarket, punishte të mëdha dhe funksione të tjera të përcaktuara më sipër të cilat shkaktojnë kontrast me aktivitetet tjera dhe zbehin ndjenjën e vazhdimësisë.



## ANEKS 3

### **Parku i Erenikut**

(referimi në materialin grafik)

Natyra gjithpërfshirëse e qytezës së Junikut ka përfaqësuesen e vet më të mirë, lumin Erenik dhe kodrën e Moronicës. Përgjatë shtratit të lumbit si pjesë e ekosistemit haset një gjelbërim i dendur. Në anën veri-perëndimore në të ngjitur të lumbit shtrihet një hapësirë e lirë, e gjelbërt me potencial për tu pajisur dhe për tu kthyer në park urban. *Vendosja në komunikim dhe kualifikimi i sipërfaqeve që kufizojnë shtratin e lumbit, janë thelbi i dizajnit për Parkun e Erenikut.*



Lumi Erenik: Foto Metro-Polis

Destinacioni për *hapesirë të gjelbërt publike* do ti jap status të merituar njëherë e përgjithmonë kësaj tërësie hapësinore deri tani të lënë djerrë dhe pre të abuzimeve. Komunikimi me Moronicën do ta kthejë Parkun e Erenikut në një urë lidhëse me natyrën e virgjër të Bjeshkëve të Nemuna duke kontribuar në mirëqenien e popullatës vendase dhe njëkohësisht do të jetë mbështetje për turizmin natyror.




Fig. 24 Parku i Erenikut, Sektoret përbërëse - Pjesë nga Harta e Destinimit të Sipërfaqeve, PRru-Junik

**1. Përbërja dhe organizimi hapësinor.** Parku i Erenikut si një sistem, përfshin katër sektore kryesore:

a. *Shëtitja*, mendohet të shtrihet përgjatë lumit Erenik duke filluar nga ura aktuale që bënë lidhjen me Batushën duke vazhduar në drejtim të veriut. Ky park linear mendohet të organizohet sipas dy trajektoreve me gjelbërim ndërmjet. Njëra ndjek aksin Junik-Batushë dhe shërben njëkohësisht si trotuar dhe tjetra përgjatë shtratit të lumit duke vazhduar për të gjithë gjatësinë e parkut. Pozicioni i parkut në hyrje të qytezës nga ana perëndimore bënë të domosdoshëm planifikimin e një parkimi i cili mund të pozicionohet përgjatë rrugës Junik-Batushë, duke ndarë trotuarin me rrugën. Rende të vazhdura gjelbërimi të lartë mund të perimetrojnë rrugën duke krijuar edhe një dialog me pejsazhin perëndimor. Përgjatë trotuarit nga ana e lumit mund të planifikohen sipërfaqe apo ishuj, të mbjella me shkurre dekorative apo lule sezionale që do ti shoqërojnë këmbesorët përgjatë koridorit që të shpien në qendër të qytezës. Gjithashtu ky sektor mund të përmbajë ishuj të shtruar me pllaka guri të pajisura me stola për pushim. Sheshe të vogla lojrash për fëmijë mund të jenë pajisje të tjera që rrisin frekuentueshmërinë e këtij sektori.



Burimi: Internet

b. *Shtëpia e Kulturës.* Ky sektor përfshin ish ndërtesën e kooperativës dhe truallin përreth saj. Objekti sot i braktisur dhe i degraduar, zë një pikë kyçë në vazhdimesinë e parkut me potencial për përfshirjen e funksioneve komplementare. Është objekti i parë publik që vizitorit takon në hyrje nga perëndimi dhe si i tillë duhet të fuqizohet me funksione publike në shërbim të komunitetit duke favorizuar integrimin. Pozicioni në hyrje dhe në afërsi të parkingut të menduar përgjatë shëtitores, bënë që ky lokacion të kthehet në një pol të shkallës territoriale. Afërsia me lumin Erenik dhe kodrën e Moronicës, në të njejtën kohë në krye të aksit të tregut (pazarit) jep mundesinë për të lexuar këtë objekt si një pikë lidhje e ambientit urban me natyrën duke funksionuar si çernierë ndërmjet parkut të Erenikut dhe tregut të Junikut.

Destinacioni i propozuar për këtë objekt është "Shtëpi Kulture". Funksionet që mund të përfshihen në këtë objekt sipas nevojave, mund të janë: kinema, laboratore për veprimitari artistike, sallë ekspozimi, bibliotekë, internet kafe, etj.

Duke pasur parasysh gjendjen e strukturës egzistuese, duhen ndërmarrë operacione restaurimi dhe konsolidimi të cilat nuk duhet të cenojnë esencën egzistuese e cila konsiderohet si një egzemplar arkitektonik me vlera nostal gjike për qytezën. Gjithashtu mund të shikohet edhe mundësia për shtesa ambientesh të cilat duhet të rezultojnë në harmoni vizuale dhe funksionale me objektin egzistues.




Parku përreth objektit duhet të integroj atë me shëtitoren e vazhduar si dhe me ambientin përreth. Gjithashtu një pjesë e funksioneve kulturore mund të pozicionohen edhe në qzell të hapur si pajisje për lojra tavoline, lojra për femijë, kafe, restoran, etj.



Burimi: Internet

c. Parku, shtrihet në hapësirën veriore në të ngjitur të shtratit të lumbit. Mendohet si një hapesirë rekreative, mbështetës i aktivitete sportive, pushim në natyrë, festa publike, etj. Operacione rikualifikimi duhet të kryhen në të gjithë sipërfaqen duke ruajtur gjelbërimin egzistues dhe duke e shtuar ate pa cenuar karakteristikat aktuale. Mund të përfshihen tre tipe gjelbërimi: i lartë, shkurre dhe i ulët. Shtrati i lumbit përgjatë këtij sektori gjithashtu ka nevojë për pastrim dhe rikualifikim duke i hapur pamjet nga lumi.

Intineraret duhet të pozicionohen në mënyrë hierarkike duke patur si trajektorë kryesore atë që ndjek vijën e lumbit duke krijuar vazhdimësi me shetitoren e sektoreve të mëparshëm dhe duke vazduar deri në pikën përfundimtare të parkut aty ku lidhet me Moronicën. Ndërhyrjet në brendësi të parkut duhet të janë sa më pak invazive, duke përdorur materiale natyrore si gurë apo dru në mënyrë që eksperienca në natyrë të jetë sa më intensive dhe kontrastuese me ambientin urban.






Burimi: Internet

d. *Fasha e Aktiviteteve* është pjesë e sektorit të Parkut dhe shtrihet në anën verilindore të tij. Ky rrip ose fashë e ndërtuar imët, në Hartën e Destinimit të Sipërfaqeve përkon me “*Fashë Afarizmi me dendësi të ulët*” dhe duhet ti përmbahet të gjitha përshkrimeve të cekura më sipër. Është i vetmi sektor brenda parkut ku mund të ndërtohet sipas përshkrimeve të dhëna nga ky plan.

Funksionimi i kësaj zone duhet të jetë i lidhur ngushtë me karakterin e Parkut duke siguruar funksione komplementare për të. Disa nga përdorimet e keshillueshme që mund të ndikojnë në shfrytëzimin e hapësirës në kompaktibilitet me hapësirën e gjelbërt publike mund të janë: hoteli, agriturizëm, restorante, parqe ujore/ pishina, sera lulesh apo për prodhime bujqësore, minikomplekse sportive.

Funksione jokompatibile me Parkun, pavarësisht së janë përmëndur në mënyrë përgjithësuese në funksionet e lejuara për këtë fashë janë: punishte prodhimi të mëdha dhe të vogla, oficina automjetesh, magazina. Pra çdo funksion që shkakton ndotje ambientale dhe vizuale.

Ndërtimet në këtë sektor duhet të janë në harmoni me natyrën. Sikurse përcaktohet edhe nga koeficientët urbanistik, dendësia e ndërtimit duhet të jetë e ulët, me sipërfaqe të mëdha të gjelbërtë. Lartësia e objekteve duhet të jetë e reduktuar dhe nëpërmjet çative me thyerje të shkrihet mirë me truallin. Materialet e ndërtimit duhet të janë autoktone si gurë apo dru për të krijuar një atmosferë të ëmbël vernakulare.



Burimi: Internet

